

Sondazhi i opinionit publik 2022



Edicioni i 10^{-të}



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

With funding from
 Austrian
Development
Cooperation





Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



Sondazhi i opinionit publik 2022: Besimi në qeverisje

Edicioni i 10^{të}

Autorë:

Irma Semini
Besjana Kuçi
Marsela Dauti

Koordinatorë e punës në terren:

Sheila Hafizi

© Maj 2023 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Address: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

Website: www.idmalbania.org

Ky raport u përgatit në kuadër të Projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, që zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribuues kryesor, së bashku me UNDP-në. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të qeverisë shqiptare, UNDP-së, apo ADC-së.

BESIMI NË QEVERISJE: PERCEPTIMET NDËR VITE

Sondazhi i Opinionit Publik "Besimi në Qeverisje" vjen me edicionin e tij të dhjetë, i cili paraqet një përmbledhje të tendencave të rëndësishme që janë shfaqur gjatë periudhës 2013-2022 dhe analizën e të dhënave të vitit 2022. Duke analizuar të dhënat e agreguara ndër vite, synojmë të bëjmë të mundur paraqitjen e një panorame të plotë të evolucionit dinamik të aspekteve të ndryshme të qeverisjes në Shqipëri.

Perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështjet e trajtuara nga Sondazhi i Opinionit Publik të vitit 2022 mund të jenë ndikuar nga faktorë të ndryshëm kontekstualë. Veçanërisht, vendimi i qeverisë për të kaluar të gjitha shërbimet publike online duke filluar nga 1 maji 2022 mund të ketë ndikuar ndjeshëm te perceptimet e qytetarëve për marrjen dhe dixhitalizimin e shërbimeve. Po ashtu, ndikim mund të kenë pasur edhe rastet e sulmeve kibernetike ndaj institucioneve qeveritare. Mund të ketë luajtur një rol edhe ndjekja penale e rasteve me akuzat ndaj zyrtarëve të lartë shtetërorë për abuzimin me pushtetin, korrupsion dhe pastrim parash. Nga ana tjetër, hapja e negociatave të anëtarësimit në BE për Shqipërinë mund të ketë ndikuar në perspektivat për qeverisjen, llogaridhënien dhe çështje të tjera të rëndësishme.

Gjetjet kryesore grupohen në tetë pjesë:

PJESA I – BESIMI NË INSTITUCIONE 2022

- Organizatat si NATO (74.2%), OKB (71.3%), dhe BE (70.9%) e ruajtën renditjen e tyre si institucionet më të besuara në Shqipëri.
- Institucionet fetare (64.2%) vazhdojnë të jenë institucionet shqiptare më të besuara, të ndjekura nga forcat e armatosura (59.5%), institucionet arsimore (54.5%) dhe organizatat e shoqërisë civile (53.6%).
- Partitë politike (29.5%), parlamenti (33.8%), prokuroria (35.2%) dhe gjykatat (36.2%) renditen si institucionet më pak të besuara për vitin 2022, edhe pse kanë shënuar një përmirësim krahasuar me vitin 2021. Besimi i publikut në gjykata është rritur me tetë pikë përqindjeje (pp) krahasuar me vitin 2021 (28%).
- Në vitin 2022, besimi i publikut te presidenti ka shënuar një rritje të konsiderueshme, në 41%, krahasuar me shifrat midis 24-28% gjatë viteve 2019-2021.
- Gjysma e të anketuarve kanë besim te Struktura e Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), e cila iu shtua listës së institucioneve të anketuara në vitin 2022. Kjo përqindje (50%) është më e lartë krahasuar me nivelet e besimit të raportuar për prokurorinë dhe gjykatat.
- Në vitin 2022, 35% e shqiptarëve besonin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi, njësoj si në vitin 2021 (35%). Gjithsesi, besimi i publikut se kjo reformë do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e vendit është ulur ndjeshëm vitin e fundit në 47%, një rënie prej 10 pp krahasuar me vitin 2021 (57%).
- Gjysma e shqiptarëve të anketuar (51.3%) e konsideronin televizionin si median më popullore, krahasuar me mediat sociale (30.6%) dhe portalet online (11.6%), duke konsoliduar kështu prirjen në rritje të televizionit si burimi kryesor për lajmet mbi aktualitetin gjatë dy viteve të fundit.

- 38.6% e të anketuarve besonin se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare ishte i saktë/i vërtetë.
- Pak më shumë se gjysma e shqiptarëve (51.1%) raportuan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e ndihmës së huaj (me donatorët) në Shqipëri gjatë vitit 2022.

NDËR VITE

- Institucionet fetare janë perceptuar vazhdimisht nga të anketuarit si institucionet shqiptare më të besuara në vitet 2015-2022, besim që, gjithsesi ka pasur një tendencë në rënie.
- Partitë politike, gjykatat, prokuroria dhe parlamenti janë renditur ndër institucionet më pak të besuara gjatë këtyre viteve.
- Organizatat ndërkombëtare kanë qenë institucionet më të besuara në përgjithësi, vazhdimisht me mbi 70%, ndonëse shifrat kanë pësuar një rënie gjatë viteve 2019-2022.
- Besimi i publikut në zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi ka qenë i ulët gjatë viteve 2018-2020. Megjithatë, viti 2021 shënoi një pikë kthese, me një rritje prej 6 pp, rritje që vazhdoi në të njëjtin ritëm edhe në vitin 2022.

PJESA II – TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA 2022

- Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar e konsideronin qeverinë qendrore (59.4%) dhe bashkinë (60.2%) si jotransparente.
- Pjesa më e madhe e popullsisë (65.3%) ishin në dijeni se ligji u garanton të drejtën e informimit, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2021 (62%).
- Shumica e shqiptarëve mendonin se si qeverisë qendrore, ashtu edhe qeverisjes vendore u mungon llogaridhënia. Perceptimi i llogaridhënies ishte i përafërt për të dy nivelet e qeverisjes: ku 36% e të anketuarve e konsideronin të përgjegjshme qeverisjen qendrore dhe 37.8% atë vendore.
- Organizatat ndërkombëtare (70.4%) mendohet se i kërkojnë llogari qeverisë më shumë se institucionet vendase të renditura në këtë sondazh ndonëse kanë pësuar një rënie prej 7 pp në krahasim me vitin 2021.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) konsiderohet si institucioni vendas më efektiv në vend për kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (63.4%), i ndjekur nga parlamenti (58.4%) dhe media (55%), ndonëse secili me ulje të ndjeshme: KLSH (-8 pp), parlamenti (-6 pp) dhe media (-6,5 pp), krahasuar me vitin 2021.

NDËR VITE

- Më pak se gjysma e të anketuarve në vitet 2016-2022 e kanë konsideruar qeverisjen qendrore dhe atë vendore si transparente ose të përgjegjshme. Perceptimi publik si për transparencën ashtu edhe për llogaridhënien është luhatur në shifra të ngjashme.

- Që nga viti 2016, qeverisja vendore është vlerësuar vazhdimisht pak më e përgjegjshme se niveli qendror, me një mesatare prej 38% krahasuar me 35%. Gjithsesi, në vitin 2019 për nivelin vendor të qeverisjes është vënë re një rënie e ndjeshme me 7pp. Nga ana tjetër, qeveria qendrore perceptohet si më transparente, me një vlerësim mesatar prej 40% krahasuar me 37% për qeverisjen vendore. Gjithsesi, në rastin më të mirë shifrat mbeten nën 45%.
- Kontrolli i Lartë i Shtetit është evidentuar vazhdimisht si mekanizmi më efikas i llogaridhënies së brendshme (llogaridhënia horizontale) nga më shumë se gjysma e të anketuarve, me një mesatare prej 64% nga viti 2016 deri në vitin 2022. Pas tij vjen parlamenti me një mesatare prej 56% e të anketuarve.
- Organizatat ndërkombëtare janë konsideruar vazhdimisht nga shumica e të anketuarve (me një mesatare prej 73%) se i kërkojnë më shumë llogari qeverisë krahasuar me institucionet vendase gjatë viteve 2016-2022. Media është evidentuar vazhdimisht si mekanizmi më efikas i llogaridhënies vertikale në vend nga më shumë se gjysma e të anketuarve, me një vlerësim mesatar prej 59% për periudhën në fjalë.

PJESA III – KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE 2022

- Shumica e shqiptarëve (76.5%) e konsiderojnë korrupsionin e vogël (e nivelit të ulët) si të përhapur ose shumë të përhapur, krahasuar me 79.1% që kanë këtë mendim për korrupsionin e madh (e nivelit të lartë). Për të dy nivelet e korrupsionit, shifrat kanë pësuar rënie prej vitit 2021, veçanërisht për korrupsionin e nivelit të ulët (-6 pp nga 2021 dhe -10 pp nga 2019 dhe 2020).
- Plot 65.8% e shqiptarëve nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh, ndërsa 56.9% nuk kanë besim në ndëshkimin efektiv të korrupsionit të vogël.
- Ndërkohë, 15.4% e shqiptarëve raportuan se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel të qeverisjes qendrore dhe 21.6% në qeverisjen vendore.
- 32.7% e qytetarëve që kanë marrë shërbime nga qeverisja vendore në vitin 2022, raportuan se kishin paguar ryshfet një zyrtari publik të këtij niveli.
- 30.9% e qytetarëve që kanë marrë shërbime të qeverisë qendrore në vitin 2022, raportuan se kishin paguar ryshfet një zyrtari të këtij niveli.
- Për sa i përket arsyeve për dhënien e ryshfetit, 50.3% raportuan se u ishte kërkuar, 24.4% thanë se kanë paguar për të marrë shërbime më të mira herën tjetër, ndërsa 14.1% kanë paguar si mirënjohje për shërbimet e marra.
- Mes të anketuarve që kanë paguar ryshfet, vetëm 11.2% (N=64) e kanë raportuar atë tek autoritetet, që do të thotë 88.8% (N=508) nuk e kanë raportuar. Arsyet që u përmendën më shpesh për mos-raportim ishin: 37.4% e konsideronin ryshfetin si diçka e zakonshme, 32.1% e mendonin raportimin si të padobishëm dhe 12.3% kishin frikë nga pasojat e raportimit.

NDËR VITE

Përhapja e korrupsionit

- Në vitet 2019-2022, shumica dërrmuese e të anketuarve e konsideronin korrupsionin e madh dhe atë të vogël si “të përhapur ose shumë të përhapur”, me vlerësime që kalojnë nivelin e 75% të të anketuarve.
- Në vitin 2022 ka pasur një rënie të dukshme në perceptimin e korrupsionit të vogël, - 6 pp krahasuar me 2021 dhe -10 pp krahasuar me vitet 2019 dhe 2020.

Besimi në ndjekjen penale të korrupsionit

- Më pak se një e treta e të anketuarve kishin besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh në vitet 2017-2022 (me 25%-32% të të anketuarve).
- Të anketuarit raportuan vazhdimisht besim më të madh në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël (41%) krahasuar me korrupsionin e madh për të njëjtën periudhë (32%). Pavarësisht luhatjeve ndër vite, besimi i të anketuarve në ndjekjen penale të korrupsionit të madh dhe atij të vogël është përmirësuar në përgjithësi, ndonëse me vlera të vogla.

PJESA IV – NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE 2022

- Gjykatat (41.8%) konsiderohen si institucionet më të ndikuara politikisht, edhe pse perceptohen si më pak të tilla krahasuar me një vit më parë (49% në 2021)..
- 37.9% e konsideronin SPAK-un ‘pak ose aspak të ndikuar’ nga interesat politike, ndërsa 31.8% e shqiptarëve e konsideronin atë si ‘shumë të ndikuar ose jashtëzakonisht të ndikuar’.
- Institucionet fetare shiheshin si institucionet më pak të ndikuara politikisht, ashtu si edhe në vitin 2021 (11%). Vetëm 12.4% e qytetarëve i konsiderojnë ato si ‘shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara’.

NDËR VITE

- Perceptimi i publikut për institucionet që zakonisht konsiderohen si ‘shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika është përmirësuar me kalimin e viteve, veçanërisht për gjykatat dhe prokurorinë.

PJESA V – PJESËMARRJA QYTETARE 2022

- Përqindja e shqiptarëve të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje në vitin 2022 nuk ka ndryshuar shumë nga viti 2021 (45.3% kundrejt 43.5%).
- Në 2022, më pak qytetarë raportojnë se kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore (37.8%) në krahasim me nivelin qendror të qeverisjes (27.4%).
- Një pjesë relativisht e vogël e publikut (18.1%) raportoi se kishte përdorur portalin www.konsultimipublik.gov.al.
- Shumica dërrmuese e qytetarëve (73%) janë dakord me pohimin se kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse vendimet e qeverisë janë të mira apo të këqija.
- Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar (60.9%) besojnë se dëgjesat publike në nivel vendor janë ngjarje formale që kanë ndikim të kufizuar në vendimet e bashkisë, ndërkohë që vetëm 39.2% besojnë se sugjerimet e organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit merren parasysh.
- 37.6% e të anketuarve janë dakord me pohimin se këshillat bashkiakë përfaqësojnë komunitetet vendore dhe 36.6% janë dakord se buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve.
- Përqindja e popullsisë që ka marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo që ka nënshkruar një peticion u rrit nga 27.1% në 2021 në 32.2% në 2022.
- 61.5% e qytetarëve ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare.
- Në vitin 2022, 38.3% e popullsisë në Shqipëri dëshiron të largohej drejt një shteti tjetër, përqindje pak më e ulët se ajo e vitit 2021 (41%).

NDËR VITE

- Në periudhën 2016-2022, përqindja e qytetarëve që raportuan se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të qeverisjes qendrore dhe vendore është nën 40%. Që nga viti 2019, vihet re një stanjacion lidhur me mundësitë e perceptuara për pjesëmarrje në vendimmarrjen e të dy niveleve të qeverisjes.
- Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore shënuan rezultate më të larta, me një mesatare prej 37%, krahasuar me nivelin qendror, i cili kishte një mesatare prej 27% në vitet 2016-2022.
- Pjesëmarrja faktike në konsultimet publike shënon vlera më të ulëta, nën 25%, krahasuar me mundësitë e perceptuara përgjatë periudhës në fjalë.
- Arsyet kryesore që të anketuarit dhanë për mospjesëmarrjen në proceset e konsultimit në vitet 2016-2022 ishin mungesa e besimit se pjesëmarrja do të kishte ndikim, pritshmëria se duhet të merrnin pjesë njerëz të tjerë dhe besimi se nuk ekzistojnë mekanizma apo procese konsultimi.
- Vitet e fundit ka pasur një pjesëmarrje më të madhe në aktivizmin qytetar. Përqindja e shqiptarëve që raportuan se kanë marrë pjesë në tubime/demonstrata apo që kanë nënshkruar peticione u rrit pas

vitit 2020 dhe në vitin 2022 shifrat ishin 10 pp më të larta se në vitin 2016 (32% kundrejt 22%). Arsyet kryesore që u dhanë nga të anketuarit ishin interesat personale dhe interesat e përbashkëta të komunitetit ku jetojnë.

- 46% e shqiptarëve kanë dashur të largohen drejt një shteti tjetër në vitin 2019. Kjo shifër është ulur me 8 pp në vitin 2022 në 38%. Arsyet kryesore për dëshirën për t'u larguar drejt një shteti tjetër lidhen me mundësitë për një jetë më të mirë, me faktorët ekonomikë dhe zhvillimin profesional.

PJESA VI – KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE 2022

- Mesatarisht 39.1% ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me ofrimin e shërbimeve publike kryesore, nivele që janë të ngjashme me ato të vitit 2021.
- Në përgjithësi, nivelet e kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike u ulën për pjesën më të madhe të shërbimeve publike bazë dhe ato administrative të matura në këtë sondazh, krahasuar me vitin 2021.
- Shërbimi i arsimit publik (46.4%), furnizimit me ujë të pijshëm (46.4%), pastrimit (46.2%) dhe ato të shëndetit publik (43.4%) janë raportuar më shpesh si të kënaqshme në krahasim me shërbimet e policisë (35.9%), transportit publik (31.8%) dhe shërbimet gjyqësore (25.8%), ndonëse shifrat kanë pësuar rënie. Konkretisht, kënaqshmëria e publikut me ofrimin e shërbimeve të arsimit publik dhe shërbimeve të emergjencave ka shënuar rënie të ndjeshme, - 7 pp për arsimin, -7 pp për shërbimin e urgjencës (ambulancat) dhe - 9 pp për zjarrfikësit, krahasuar me shifrat e vitit 2021.
- 56% e qytetarëve shqiptarë që kishin përdorur një shërbim administrativ në vitin 2022 ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur”, veçanërisht kur bëhej fjalë për gjendjen civile (52%), sigurimet shoqërore (39.4%) dhe transportin rrugor (38.5%). Gjithsesi, shifrat për shërbimet e gjendjes civile janë ulur ndjeshëm, me -8 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2021.
- Vetëm 13.4% e të anketuarve kanë dorëzuar një ankesë tek institucioni që ka dhënë shërbimin publik, përqindje e ngjashme me atë të raportuar në sondazhin e vitit 2021 (15.1%).
- Vetëm 9.5% e qytetarëve e kishin përdorur platformën online të bashkëqeverisjes www.shqipëriaqeduam.al për të bërë një ankesë. 31.8% e atyre që kanë bërë ankesë në këtë platformë thanë se ankesa ishte zgjidhur.
- 24.9% e qytetarëve besojnë se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve.
- 59.3% e qytetarëve të anketuar nuk ndiheshin të sigurt në jetën e përditshme, duke shënuar një rënie të ndjeshme prej 12 pp, krahasuar me 71.6% në vitin 2021. Tre faktorët kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë janë kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standarde dhe pasiguria për vendin e punës.

NDËR VITE

- Mesatarisht, më pak se gjysma e të anketuarve kanë qenë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me ofrimin e shërbimeve bazë publike gjatë periudhës 2016-2022, duke mbetur brenda një intervali të ng-

jashëm në katër vitet e fundit (2019-2022), me vlerësime që luhaten në 38%-42%.

- Në vitet 2019-2022, përdoruesit e shërbimeve publike administrative kanë raportuar vlera shumë më të larta se niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë i raportuar nga të gjithë qytetarët e anketuar, duke arritur një nivel kënaqshmërie prej 56% në vitin 2022.

PJESA VII – PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) 2022

- Pjesa më e madhe e publikut (64.9%) ishin të informuar se bashkia e tyre ka një faqe interneti, një përqindje dukshëm më e lartë se në vitin 2021 (59.7%), që tregon një prirje të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij treguesi. 45.9% e qytetarëve kanë raportuar se e përdorin faqen e internetit të bashkisë, përqindje më e lartë krahasuar me vitin 2021 (40.7%).
- Shumica dërrmuese e të anketuarve (90.7%) raportuan se ishin në dijeni se administrata shtetërore ofron shërbime elektronike përmes portalit e-Albania. Ndër ta, për vitin 2022, 82.9% raportuan se marrin shërbime elektronike përmes portalit e-Albania.
- Më pak se gjysma e qytetarëve (47.9%) raportuan se i merrnin shërbimet në portalin e-Albania pa ndihmën e të tjerëve.
- Përqindja e qytetarëve që i cilësuan shërbimet e ofruara nga portali e-Albania si funksionale (-6.2 pp), të lehta për t'u përdorur (-9.7 pp) dhe që shkurtojnë kohë për marrjen e tyre (-4.2 pp) ishte më e ulët në 2022 sesa në 2021. 52.6% e të anketuarve ishin dakord se shërbimet elektronike u bëjnë të mundur qytetarëve të shprehin komente/sugjerime.
- Mbrojtja e të dhënave personale ishte e rëndësishme për shumicën dërrmuese të të anketuarve (90.3%). Megjithatë, më shumë se gjysma e tyre nuk besonin se të dhënat personale administroheshin siç duhet, qoftë nga aktorët publikë (59.8%), qoftë nga sektori privat(58.8%).

NDËR VITE

- Përqindja e qytetarëve që janë në dijeni se bashkia ku jetojnë ka një faqe interneti paraqet një tendencë dukshëm në rritje nga viti 2014 deri në vitin 2022. Megjithatë, përqindja e përdoruesve të faqes së internetit të bashkisë nuk është rritur me të njëjtin ritëm si ajo e atyre që janë në dijeni për të.
- Pjesa e të anketuarve që kanë dijeni për portalin e-Albania është rritur ndjeshëm që nga viti 2018 (54%), në 91% në 2022.
- Po kështu, përqindja e qytetarëve që kanë marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania është rritur ndjeshëm nga 38% në 2019 në 75% në 2022.

PJESA VIII – PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE 2022

- 61.5% e shqiptarëve ishte dakord se ka barazi midis burrave dhe grave, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2021.
- Më shumë se tre të katërtat e shqiptarëve (77.1%) besojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike, që është pak më e lartë se vitin e kaluar.
- Shumica e qytetarëve (72.4%) në vitin 2022 besojnë se nëpunësit publikë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave, përqindje më e ulët se në vitin 2021.
- Shumica dërrmuese e të anketuarve (77.5%) mendojnë se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë për të mbajtur çdo post publik, përqindje më e ulët se në vitin 2021.
- Në vitin 2022, 14.6% e të anketuarve raportuan se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, paaftësisë apo arsyeje tjetër, përqindje pak më e lartë se në vitin 2021 (11.8%).
- Pothuajse tre në pesë persona (58%) besonin se rritja e numrit të grave në këshillin bashkiak ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore, përqindje që është dukshëm më e ulët se në vitin 2021 (64%).

NDËR VITE

- Të dhënat në vite (2016-2022) tregojnë se përgjithësisht më shumë se gjysma e të anketuarve janë dakord se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqëri. Burrat ishin më shumë të prirur në krahasim me gratë të ishin dakord se ka barazi gjinore, me një mesatare prej 61%, krahasuar me 50% për gratë.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve besojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtën akses në shërbimet publike, pa dallime të konsiderueshme në perceptimet mes grave dhe burrave.
- Gjatë viteve 2016-2022, përqindja e të anketuarve që raportuan se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion ose nëpunës publik për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, përkatësisë etnike, moshës, gjinisë ose për arsye të tjera nuk ka pasur ndonjë ndryshim të ndjeshëm. Vlerat varionin nga 12% në 16%.
- Përqindja e të anketuarve që janë dakord se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë për të mbajtur poste publike ka mbetur dukshëm e lartë, me një mesatare prej 80%, që kur kjo pyetje u bë për herë të parë në vitin 2016. Vlerësimi më i ulët ishte 77% i vitit 2019.

TABELAT

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2022 dhe madhësia e kampionit për secilin qark.....	19
Tabela 2: Përqindja e të anketuarve sipas grupmoshës.....	21
Tabela 3: Statusi i punësimit.....	22
Tabela 4: Përqindja e të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare.....	24
Tabela 5: Besimi në institucione në vite (2015–2022).....	28
Tabela 6: Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim').....	34
Tabela 7: Ndarja demografike e reformës në drejtësi (2022).....	35
Tabela 8: Ndarja demografike e përdorimit të mediave (2022).....	36
Tabela 9: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2022).....	46
Tabela 10: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale (2022).....	47
Tabela 11: Arsyet e pagimit të rryshfetit (2022).....	56
Tabela 12: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016-2022).....	59
Tabela 13: Ndarja demografike e institucioneve ‘shumë të ndikuara’ ose ‘jashtëzakonisht shumë të ndikuara’ nga politika (2022).....	60
Tabela 14: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet konsultuese në vitin 2022.....	65
Tabela 15: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendim-marrje (2022).....	71
Tabela 16: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2022—Vetëm përgjigjet e kategorisë “Po”	72
Tabela 17: Ndarja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në (2022)- Përgjigjet “Jam dakord” dhe “Jam plotësisht dakord”.....	73
Tabela 18: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative (2022).....	77
Table 19: Reasons for feeling unsafe (2016–2022).....	82
Tabela 20: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas karakteristikave demografike (2022).....	83
Tabela 21 : Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative sipas karakteristikave demografike (2022).....	84
Tabela 22: Arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (2022).....	88
Tabela 23: Aksesimi në shërbimet e portalit e-Albania (2022).....	89
Tabela 24: Diskriminim nga institucioni (2022).....	98

FIGURAT

Figura 1: Përfaqësimi gjinor	21
Figura 2: Përfaqësimi gjeografik	21
Figura 3: Niveli i arsimit të përfunduar	22
Figura 4: Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)	23
Figura 5: Besimi në institucione (2022)	27
Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi (2022)	29
Figura 7: Besimi i publikut se reforma në drejtësi do të zbatohet me korrektësi (2016-2017)	30
Figura 8: Përqindja e të anketuarve që besojnë në zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi (2018-2022)	30
Figura 9: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin në 2022	31
Figura 10: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2022	32
Figura 11: Saktësia e mediave (2016-2022)	32
Figura 12: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri (2022)	33
Figura 13: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore (2022)	37
Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit (2022)	39
Figura 15: Perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore dhe vendore (2022)	40
Figura 16: Transparenca dhe llogaridhënia institucionale (2016-2022)	41
Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale (2022)	43
Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale (2022)	44
Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2022)	49
Figura 20: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 'I përhapur' ose 'Shumë i përhapur' (2019 – 2022)	50
Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2022)	51
Figura 22: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017-2018)	52
Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin (2022)	52
Figura 24: Përvoja personale me korrupsionin (2016-2022)	53
Figura 25: Shërbimet e marra në nivel qendror (2022)	54
Figura 26: Ryshfet i paguar në nivel qendror (2022)	54
Figura 27: Shërbimet e marra në nivel vendor (2022)	55
Figura 28: Ryshfet i paguar në nivel vendor (2022)	55
Figura 29: Përhapja e ryshfetit (2016-2022)	56
Figura 30: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në agjendën e institucioneve (2022)	58
Figura 31: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike (2022)	61
Figura 32: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2022)	62
Figura 33: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2016–2022)	62
Figura 34: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2022)	63
Figura 35: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016-2022)	64
Figura 36: Pjesëmarrja në takime konsultimi (2022)	64
Figura 37: Përdorimi i portalit “Konsultimipublik.gov.al” në vitin 2022	65

Figura 38: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar (2022).....	66
Figura 39: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2022	67
Figura 40: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni (2016-2022).....	68
Figura 41: Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare (2022).....	68
Figura 42: Largimi nga vendbanimi aktual (2022).....	69
Figura 43: Largimi nga vendbanimi aktual (2019-2022).....	70
Figura 44: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2022	75
Figura 45: Përqindja e të gjithë të anketuarve “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet publike bazë (2016-2022).....	75
Figura 46: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2022.....	76
Figura 47: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative: Përdoruesit përkundrejt gjithë të anketuarve (2019 – 2022).....	78
Figura 48: Përqindja e të anketuarve që kishin bërë ankesë tek institucionet (2016–2022).....	79
Figura 49: ankesa tek platforma e bashkëqeverisjes ‘www.shqipëriaqeduam.al’ (2022).....	80
Figura 50: Institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve (2016 - 2022).....	80
Figure 51: Perceived safety in everyday life (2016–2022)	81
Figura 52: Dijeni për faqen e internetit të bashkisë (2022).....	85
Figura 53: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2022).....	86
Figura 54: Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni që bashkia ka një faqe interneti (2014-2022).....	86
Figura 55: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2016-2022).....	87
Figura 56: Dijeni për portalin e-Albania (2022)	88
Figura 57: Përqindja e të anketuarve që kanë marrë shërbime elektronike përmes portalit e-Albania (2022).....	89
Figura 58: Vlerësimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2022).....	90
Figura 59: Përqindja e të anketuarve që kanë dijeni për portalin e-Albania (2018-2022).....	90
Figura 60: Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale (2022).....	91
Figura 61: Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga aktorët publikë	92
Figura 62: Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga sektori privat.....	92
Figura 63: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2022)	93
Figura 64: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016–2022).....	94
Figura 65: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ (2022).....	95
Figura 66: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ (2016-2022).....	95
Figura 67: ‘Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’ (2022)	96
Figura 68: ‘Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’ (2016–2022)	97
Figura 69: ‘Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike’ (2016-2022).....	99
Figura 70: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur poste publike (2022).....	99
Figura 71: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë (2016-2022).....	100

PËRMBAJTJA

Besimi në qeverisje: perceptimet ndër vite	4
PJESA I – BESIMI NË INSTITUCIONE 2022	4
Ndër vite	5
PJESA II – TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA 2022	5
Ndër vite	5
PJESA III – KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE 2022	6
Ndër vite.....	7
PJESA IV – NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE 2022	7
Ndër vite	7
PJESA V – Pjesëmarrja qytetare 2022.....	8
Ndër vite	8
PJESA VI – KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE 2022	9
Ndër vite.....	9
PJESA VII – PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT (TIK) 2022	10
Ndër vite	10
PJESA VIII – PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE 2022	11
Ndër vite	11
1. Hyrje	17
2. METODOLOGJIA	18
2.1 Metodologjia statistikore dhe përshkrimi statistikor i kampionit.....	18
2.2 Instrumenti i sondazhit.....	19
2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave	20
3. Demografia e Kampionit	21
4. Rezultatet e Sondazhit të Opinioneve për 2022 dhe ndër vite.....	25
4.1 Besimi në institucione	25
4.2 Transparenca dhe llogaridhënia	37
4.3 Korrupsioni në institucionet publike	49
4.4 Ndikimi i interesave politike	57
4.5 Pjesëmarrja qytetare.....	61
4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	74
4.7 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.....	85
4.8 Përfshirja gjinore dhe sociale	93
Shtojca 1: Karakteristikat e kampionit (2013-2022)	101

1. HYRJE

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë pësuar ndryshime të rëndësishme teksa kanë ecur drejt një shoqërie të hapur dhe demokratike. Vitet e fundit, programet e reformave janë nxitur nga procesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Në Shqipëri, përmirësimi i funksionimit të institucioneve demokratike, i administratës publike, sundimit të ligjit dhe zhvillimit ekonomik janë vetë thelbi i këtyre reformave¹. Zbatimi me korrektësi i këtyre reformave dhe hapja e negociatave të anëtarësimit janë aktualisht faktorë të rëndësishëm në perceptimin e publikut shqiptar për qeverisjen. Së bashku me problematikat afatgjata, si besimi në qeverisje, ofrimi i shërbimeve publike dhe llogaridhënia publike, këto janë elementë të rëndësishëm që përcaktojnë mbështetjen apo refuzimin për status quo-në në shoqërinë shqiptare.

Sondazhi i Opinioneve 'Besimi në qeverisje' është një instrument i vlefshëm që përdoret për të matur çdo vit besimin e publikut te qeverisja dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike. Ai ka si objekt kryesor shqyrtimin e perceptimeve dhe qëndrimeve të publikut për çështje të tilla si besimi në institucionet publike; transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike; përhapja e korrupsionit; niveli i angazhimit të qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese. Po ashtu, sondazhi i opinioneve siguron të dhëna që ndihmojnë në përmirësimin e reformave madhore që lidhen me qeverisjen e mirë, antikorrupsionin, reformën në gjyqësor dhe çështjet që ndikojnë tek të gjithë sektorët, siç janë barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Në këtë edicion të raportit prezantohen gjetjet nga Sondazhi i Opinioneve 2022 dhe shqyrtohen tendencat kryesore që janë vëzhguar në këto dhjetë vitet e fundit. Ky sondazh u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ndërsa puna në terren u krye gjatë periudhës 18 nëntor-5 dhjetor 2022 në të gjitha bashkitë e vendit. Raporti fillon me një përshkrim të metodologjisë dhe karakteristikave social-demografike të kampionit. Më pas vazhdohet me prezantimin e gjetjeve të sondazhit të grupuara në tetë seksione kryesore: besimi në institucione; transparenca dhe llogaridhënia; korrupsioni në institucionet publike; ndikimi i interesave politike; pjesëmarrja qytetare; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe përfshirja gjinore dhe sociale. Duhet theksuar se në këtë edicion të dhjetë, çdo seksion përfshin edhe një analizë të tendencave që janë vëzhguar në vite.

Sondazhi i Opinioneve mbulon vitet 2013-2022 duke përdorur të njëjtin instrument vëzhgimi. Ky është edicioni i tretë i financuar në kuadër të Projektit "Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri" (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribuues kryesor, së bashku me UNDP.

¹ *Institucionet demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor, zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria konsiderohen si "bazat" e acquis communautaire nga Komisioni Evropian.*

2. METODOLOGJIA

2.1 METODOLOGJIA STATISTIKORE DHE PËRSHKRIMI STATISTIKOR I KAMPIONIT

Në Sondazhin e Opinioneve Publik 'Besimi në qeverisje 2022' u përdor një kampion përfaqësues i popullatës shqiptare në të cilin të anketuarit u përzgjedhën nga të 61 bashkitë e vendit dhe njësitë e tyre administrative. Përdorimi i një kampioni përfaqësues kombëtar të ponderuar na bën të mundur të përgjithësojmë dhe t'i aplikojmë gjetjet e sondazhit tek e gjithë popullata si një e tërë. Kështu, niveli i vlefshmërisë statistikore i kampionit përshkruhet si vijon: për popullsinë në moshë madhore prej 2,192,202 banorësh, me madhësi kampioni prej 2,500 të anketuarish, për nivel besimi prej 95%, marzhi i gabimit është ± 1.96 ; për nivel besimi prej 99%, marzhi i gabimit është ± 2.58 .

Për të përcaktuar madhësinë e kampionit për secilin nga 12 qarqet e vendit, të dhënat për popullsinë u morën nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark më 1 janar 2022 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Numri i banorëve të moshës mbi 18 vjeç në territorin e Shqipërisë ka ndryshuar me -0.98% gjatë viteve 2019-2022. Ky ndryshim duhet marrë në konsideratë nga lexuesit dhe hulumtuesit së bashkë me nivelin e besueshmërisë statistikore të kampionit të përmendur më sipër. Për rrjedhojë, ashtu si edhe në edicionet e kaluara, për të llogaritur madhësinë e kampionit për secilën bashki dhe, për më shumë detaje, për secilën njësi administrative brenda bashkisë u përdorën të dhënat sasiore nga regjistri civil i datës 1 janar 2019. Kampioni prej 2,500 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë nga 12 qarqet e vendit.

Më pas, shpërndarja sipas qarqeve u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (të moshës 18 vjeç e lart) dhe për të përdorur kontrole të kuotave sipas gjinisë. Meqenëse INSTAT nuk përcakton grupmoshat nën 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, u përdor një teknikë lineare interpolimi.

Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë për burrat shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2019 u përcaktua në 0.779325197 dhe për gratë mbi 18 vjeç në 0.790087789. Koeficienti i përgjithshëm i përfaqësimit të popullsisë për shqiptarët mbi 18 vjeç ishte 0.78472508614746². Në Tabelën 1 jepen shpërndarja sipas qarkut të popullatës rezidente shqiptare të moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit për secilin qark.

MATJA E NDRYSHIMIT NDËR VITE

Të dhënat ndër-sektoriale të mbledhura përgjatë viteve nëpërmjet të njëjtave pyetje bazë në sondazh, na bën të mundur të krahasojmë të dhënat dhe të matim ndryshimet në vite. Gjithsesi, për të krahasuar të dhënat e agreguara gjatë viteve të ndryshme u vendosën disa kritere për të siguruar vlefshmërinë e analizës. Së pari, u zgjedhën vetëm pyetjet që kishin të njëjtin formulim dhe renditje të qëndrueshme gjatë gjithë viteve. Kjo bën të mundur që të anketuarit t'i kuptojnë dhe interpretojnë pyetjet njësoj duke ruajtur kështu kontekstin e vendosur në vitet e mëparshme.

Së dyti, u përfshinë vetëm pyetjet që kanë pasur të njëjtin numër përgjigjesh dhe të njëjtën shkallë matje. Ky standardizim mundëson krahasimin në mënyrë objektive të rezultateve përgjatë viteve - duke marrë në konsideratë zhvillimet shoqërore për vitet në fjalë.

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2022 dhe madhësia e kampionit për secilin qark

Qarku	Popullsia rezidente 2019	Popullsia rezidente e moshës mbi 18 vjeç, 2019	Popullsia rezidente e moshës mbi 18 vjeç, 2022	Madhësia e kampionit për çdo qark		
				Burra	Gra	Gjithsej
Berat	125,157	96,788	90,283	51	52	103
Dibër	118,948	91,986	85,994	48	50	98
Durrës	290,126	224,364	228,610	129	132	261
Elbasan	274,982	212,653	203,332	114	118	232
Fier	294,747	227,938	218,478	123	126	249
Gjirokastrë	61,423	47,500	43,378	24	25	49
Korçë	207,889	160,767	154,829	87	90	177
Kukës	76,594	59,233	57,103	32	33	65
Lezhë	125,195	96,817	92,035	52	53	105
Shkodër	202,895	156,905	151,459	85	88	173
Tiranë	895,160	692,257	721,563	406	417	823
Vlorë	189,311	146,400	145,139	82	84	166
Gjithsej	2,862,427	2,213,610	2,192,202	1,233	1,267	2,500

2.2 INSTRUMENTI I SONDAZHIT

Çdo vit, duke filluar që nga viti 2013³, në sondazh janë bërë të njëjtat pyetje bazë për besimin në qeverisje, korrupsionin, pjesëmarrjen qytetare dhe përdorimin e TIK-ut. Gjithsesi, përmbajtja e sondazhit rishikohet çdo vit nga një grup ekspertësh të fushave të qeverisjes së mirë dhe shkencave sociale për të ruajtur ritmin me zhvillimet dhe tendencat e fundit në debatin publik. Si rezultat i rishikimeve nga ky grup ekspertësh dhe pas konsultimeve të rregullta me partnerët e zhvillimit dhe qeverisjes, këtë vit në sondazh u bënë disa ndryshime, u hoqën tre pyetje si dhe u shtuan tre pyetje të reja dhe disa alternativa përgjigjesh.

Në Kreun I, Struktura e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) iu shtua listës së institucioneve për vlerësimin e besimit të publikut dhe të perceptimit për ndikimit politik në Kreun VII. SPAK u krijua në vitin 2019 si pjesë e reformës në drejtësi dhe është një institucion i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Modifikime u bënë edhe në Kreun V “Përdorimi i TIK-ut” ku u shtuan dy pyetje dhe u rishikua një pyetje për të trajtuar shkeljet me publikimin e të dhënave personale në 2021 dhe kërcënimet e sigurisë kibernetike në vitin 2022. Duke pasur parasysh dixhitalizimin e të gjitha shërbimeve publike, opsionet e përgjigjeve u riformuluan dhe u rishikuan për të matur sa më mirë aftësitë e qytetarëve në përdorimin e shërbimeve elektronike. Përveç kësaj, në Kreun VI u hoqën pyetje të caktuara që kanë lidhje me ofrimin e

3 Të dhënat për vitin 2013 nuk janë bërë pjesë e analizës ndër vite, meqenëse ishte vit pilotimi i këtij instrumenti dhe metodologjia e mbledhja e të dhënave ka qene ndryshe nga vitet pasuese.

shërbimeve publike. Po ashtu, u hoq edhe kreu për fatkeqësitë natyrore. Së fundi, në Kreun “Demografia”, “Lëvizja Socialiste për Integrim” u riemërtua në Partia e Lirisë.

2.3 Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën intervistat ballë për ballë. Para fillimit të punës në terren, u testua pyetëtori paraprakisht dhe u trajnuan intervistuesit.

Procesi i intervistave u realizua gjatë periudhës 18 nëntor-5 dhjetor 2022 në të 61 bashkitë e vendit dhe njësitë administrative të tyre. Për mbledhjen e të dhënave u angazhuan gjithsej 43 intervistues me përvojë dhe në fund të punës në terren u kryen verifikime për kontrollin e cilësisë së të dhënave të mbledhura para hedhjes së tyre në sistem për përpunim. Të dhënat u përpunuan dhe u analizuan për të paraqitur statistika përkrahuese dhe relacionale, duke përdorur programin SPSS.

3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

Nga një kampion përfaqësues kombëtar prej 2,500 të anketuarish (të moshës +18), 51.3% ishin gra dhe 48.7% burra. Shpërndarja e kampionit sipas vendbanimit ishte 66% urbane dhe 34% rurale.

Figura 1: Përfaqësimi gjinor





Figura 2: Përfaqësimi gjeografik



Baza: N=2500

Baza: N=2500


Dy grupmoshat më të të përfaqësuara në kampion ishin 26-35 dhe 36-45 vjeç, me një përqindje prej 23.8% dhe 20.2% përkatësisht. Të rinjtë (të moshës nën 26 vjeç) përfaqësojnë 13.8% të kampionit, ndërsa të moshuarit (të moshës +66 vjeç) përbënin 9.4% të kampionit.

Tabela 2: Përqindja e të anketuarve sipas grupmoshës

Grupmoshat	Përqindja
18-25 vjeç	13.8
26-35 vjeç	23.8
36-45 vjeç	20.2
46-55 vjeç	19.2
56-65 vjeç	13.6
Mbi 66 vjeç	9.4
Gjithsej	100.0

Baza: N= 2500

Për sa i përket nivelit arsimor, grupi më i madh përfaqësohet nga ata të anketuar me arsim të mesëm (40.6%), të ndjekur nga të anketuarit që kanë diplomë universitare (ose pasuniversitare) 36.9%. Të anketuarit pa arsim përfaqësojnë vetëm 1.4% të kampionit. Përqindjet e individëve me të paktën arsim fillorë (4 klasë) dhe arsimin e detyruar (8/9 klasë) ishin përkatësisht 3.5% dhe 17.3%.

Figura 3: Niveli i arsimit të përfunduar

Baza: N=250


Në lidhje me statusin e punësimit, gjashtë në dhjetë të anketuar (59.3%) ishin të punësuar në kohën kur u bë intervista me ta. Shumica e të anketuarve të punësuar (67%) punonin në sektorin privat, 27.3% në sektorin publik ndërsa 5.7% zgjedhën opsionin “tjetër”. Gati dy në dhjetë të anketuar (19.6%) raportuan se ishin të papunë, të ndjekur nga 12.4% që ishin në pension, 6.3% ishin studentë, ndërsa 1.7% deklaruan një status të ndryshëm punësimi, si shtëpiake, punëtor sezonal, etj.

Tabela 3: Statusi i punësimit

Statusi i punësimit	N	%
I/E punësuar	1483	59.3%
<i>Spektori publik</i>	437	27.3%
<i>Spektori privat</i>	1074	67.0%
<i>Tjetër</i>	91	5.7%
<i>Gjithsej</i>	1602	100.0%
I/E papunë	491	19.6%
Student	158	6.3%
Pensionist	310	12.4%
Tjetër	43	1.7%
Refuzoj	15	0.6%
Gjithsej	2500	100.0%

Për sa i përket nivelit të të ardhurave mujore, në kohën e intervistës, 21.7% e të anketuarve nuk kishin të ardhura të rregullta. Përqindjen më të madhe (27%) e zinin ata që raportonin të ardhura mujore neto prej 30,001–50,000 lekë, të ndjekur nga 23.8% që siguronin më pak se 30,000 lekë në muaj⁴ dhe 15.9% që raportuan të ardhura të rregullta mujore prej 50,001–70,000 lekë. Vetëm 4.5% e kampionit kishin të ardhura mbi 70,001 lekë, ndërsa 7.1% e të anketuarve refuzuan të deklarorin të ardhurat e tyre.

Figura 4: Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)



Baza: N=2500

Të anketuarve të këtij sondazhi iu bënë pyetje edhe nëse identifikohen si me aftësi të kufizuara, dhe 7% deklaruan se kishin një paaftësi (N=174). Ndër ta, 63.5% (101 nga 174) raportuan se përfitonin pension invaliditeti.

Të pyetur nëse i përkisnin ndonjë grupi pakice, vetëm 6.1% deklaruan se bënin pjesë në një grup të tillë. Mes tyre, 29.8% u identifikuan si romë, 19.9% si egjiptianë, 14.9% si grekë, 9.2 si maqedonas dhe 2.8% si malazezë. Një tjetër 9.9% e atyre që e konsideronin veten se i përkisnin një grupi pakice ishin ose të një grupi që nuk ishte në listë ose refuzuan të zbulonin se në cilin grup bënin pjesë. Në Tabelën 4 më poshtë jepen më shumë hollësi.

4 Paga minimale ishte 24,000 lekë/muaj në 2015–2020, dhe u bën 30,000 lekë/muaj në 2021.

Tabela 4: Përqindja e të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	N	%
Po	152	6.1%
<i>Greke</i>	21	14.9%
<i>Maqedonase</i>	13	9.2%
<i>Arumune</i>	7	5.0%
<i>Rome</i>	42	29.8%
<i>Egjiptiane</i>	28	19.9%
<i>Malazeze</i>	4	2.8%
<i>Boshnjake</i>	3	2.1%
<i>Serbe</i>	1	0.7%
<i>Bullgare</i>	8	5.7%
<i>Refuzim/pakicë tjetër</i>	14	9.9%
Jo	2281	91.9%
Refuzim	48	1.9%
Gjithsej	2481	100.0%

4. REZULTATET E SONDAZHIT TË OPINIONIT PËR 2022 DHE NDËR VITE

4.1 BESIMI NË INSTITUCIONE

Besimi në institucione përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Sondazhit të Opinioneve Publikë "Besimi në Qeverisje". Besimi në institucione kuptohet si besimi i qytetarëve tek organizmat shtetërorë. Këtu përfshihen parlamenti, qeveria, policia, gjykatat, institucionet publike të pavarura. Duke marrë parasysh rolin e tyre në qeverisjen e vendit, në sondazh shqyrtohet besimi i publikut edhe tek entitetet jo-shtetërore si media, organizatat fetare dhe ato joqeveritare (OJQ).

Në këtë pjesë të sondazhit, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej katër pikësh nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim) se sa i besojnë 19 aktorëve kryesorë shtetërorë dhe institucioneve publike, përfshirë, për herë të parë në këtë edicion, administratën bashkiake dhe këshillin bashkiak. Supozimi bazë këtu është se shkalla e besimit në institucione të caktuara që tregohet nga të anketuarit në këtë sondazh të opinionit publik buron nga kombinimi i faktorëve në nivel makro dhe mikro. Implikimi këtu është se të anketuarit tregojnë shkallën e besimit të tyre si qytetarë bazuar në perceptimin e përgjithshëm dhe përvojat që kanë me institucionet e përmendura pa pasur nevojë të kenë njohuri dhe informacion për krijimin dhe/ose funksionimin e institucioneve përkatëse.

BESIMI NË INSTITUCIONE, REZULTATET E VITIT 2022

Në vitin 2022, organizatat ndërkombëtare si NATO (74.2%), OKB (71.3%) dhe BE (70.9%), ruajtën renditjen e tyre si institucionet më të besuara në Shqipëri. Ndërkohë, institucionet fetare (64.2%) vazhduan të konsiderohen si institucionet vendase më të besuara, të ndjekura nga forcat e armatosura (59.5%), institucionet arsimore (54.5%) dhe organizatat e shoqërisë civile (53.6%). Partitë politike (29.5%), prokuroria (35.2%), gjykatat (36.2%) dhe parlamenti (33.8%) ishin institucionet më pak të besuara në vitin 2022. 50% e shqiptarëve i besonin Strukturës së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), e cila iu shtua listës së institucioneve të anketuara në vitin 2022.

Të dhënat e sondazhit të vitit 2022 tregojnë se 5 nga 18 institucione gëzonin besimin e publikut ('kam shumë besim' apo 'kam besim' nga më shumë se gjysma e të anketuarve. Institucionet fetare (64.2%) vazhduan të jenë institucionet vendase më të besuara, të ndjekura nga forcat e armatosura (59.5%), institucionet arsimore (54.5%) dhe organizatat e shoqërisë civile (53.6%).

Për sa i përket institucioneve fetare, rreth katër në dhjetë të anketuar (39.9%) thanë se kanë besim dhe 24.3% kanë shumë besim; ndërsa në total 32.3% e të anketuarve thanë se nuk kanë besim ose nuk kanë aspak besim tek institucionet fetare. Forcat e armatosura, institucioni i dytë më i besuar në vend, 17.3% kishin shumë besim dhe besim nga 42.2% e të anketuarve; ndërkohë në total 38.2% e të anketuarve kanë treguar se nuk kanë besim ose aspak besim tek ta.

Në vitin 2022, besimi i publikut te presidenti pati një rritje të ndjeshme duke shkuar në 41%, krahasuar me nivelet prej 24%-28% në tre vitet e fundit. Kjo përqindje përbëhej nga 7.8% e të anketuarve që kishin shumë besim dhe 33.3% që kishin besim te presidentit, duke lënë 56.9% që nuk kishin besim ose aspak besim te institucioni i presidentit.

Në edicionin e këtij viti u përfshi në listën e institucioneve edhe Struktura e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK). Gjysma e të anketuarve kishin besim tek kjo strukturë. Më konkretisht, besimi i publikut në SPAK u nda në mënyrë të barabartë mes të anketuarve që thanë se i besojnë (50%) dhe atyre që nuk e besojnë (48.5%). Megjithatë, kjo përqindje është më e lartë në krahasim me nivelet e besimit të raportuara për prokurorinë dhe gjykatat.


Institucionet dhe aktorët në vend që morën vlerësimin më të ulët të besimit ishin partitë politike (29.5%), prokuroria (35.2%), gjykatat (36.2%) dhe parlamenti (33.8%), ndonëse shifrat janë përmirësuar në dy vitet e fundit. Për partitë politike, rreth shtatë në dhjetë pjesëmarrës (69%) raportuan se nuk u besojnë atyre, ndërsa më pak se një e treta (29.5%) kishin besim tek to (6.8% kishin shumë besim dhe 22.8% kishin besim). Për sa i përket prokurorisë, 37.5% e të anketuarve janë shprehur se nuk i besojnë këtij institucioni dhe 30.6% kanë deklaruar se nuk i besojnë aspak atij. Të dhënat tregojnë se besimi i publikut tek gjykatat është më i lartë se një vit më parë, ku 36.2% e të anketuarve kanë thënë se i besojnë, ndërsa 62.9% shprehen kundër (39.6% nuk kanë besim dhe 23.3% nuk kanë aspak besim). Për parlamentin, 65.4% e të anketuarve raportuan se nuk i besojnë (38.9% nuk kanë besim dhe 26.4% nuk kanë aspak besim), krahasuar me 33.8% që raportojnë se kanë besim te ky institucion.

Në vitin 2022, rezultatet nxjerrin në pah se qeveria qendrore dhe qeveria vendore gëzojnë nivele më të larta besimi sesa parlamenti dhe gjyqësori. Konkretisht, 42.6% e të anketuarve janë shprehur se i besojnë qeverisë qendrore, ku 9% thonë se kanë shumë besim dhe 33.6% se kanë besim.

Për qeverisjen vendore, katër në dhjetë pjesëmarrës në total (40.5%) thonë se kanë besim, ku 7.2% thonë se kanë shumë besim dhe 33.3% se kanë besim. Këto proporcione janë shumë të ngjashme edhe për administratën bashkiake me 40.9% të të anketuarve që kanë besim në të (8.1% kanë shumë besim dhe 32.8% kanë besim). Ndërsa, për këshillin bashkiak, vetëm 37.2% e të anketuarve kanë shprehur besim në të, përbërje që ndahet në 7.6% që kanë shumë besim dhe 29.6% që kanë besim. Një përqindje pak më e lartë e të anketuarve kanë raportuar se i besojnë më shumë administratës bashkiake sesa këshillit bashkiak.

Mesatarisht, rreth shtatë në dhjetë persona në vitin 2022 raportuan se u besonin organizatave ndërkombëtare në Shqipëri, si NATO (74.2%), OKB (71.3%) dhe BE (70.9%), nivele që janë të ngjashme me ato të vitit 2021.

Figura 5: Besimi në institucione (2022)



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

KRAHASIMI SOCIAL-DEMOGRAFIK I BESIMIT NË INSTITUCIONE

Rezultatet tregojnë se nuk ka dallime të mëdha mes grave dhe burrave për të gjitha institucionet.

Teksa kërkojmë për dallimet mes grupmoshave të të anketuarve, rezultatet tregojnë se të anketuarit e moshës 66 vjeç e lart kanë shumë më tepër gjasa të shprehin një nivel më të lartë besimi për qeverinë qendrore, qeverinë vendore, administratën bashkiake, këshillin bashkiak, presidentin dhe SPAK-un në krahasim me grupmoshat e tjera. Ndërkohë, të anketuarit e moshës 56-65 vjeç kanë më shumë gjasa të tregojnë nivele më të ulëta besimi për prokurorinë, gjykatat, partitë politike, shërbimin shëndetësor, BE-në dhe OKB-në sesa grupmoshat e tjera.

Të anketuarit që punojnë në institucionet publike janë më shumë të prirur të shprehin nivel të lartë besimi në të gjitha institucionet sesa të anketuarit që punojnë në sektorin privat, veçanërisht kur bëhet fjalë për qeverinë qendrore, pushtetin vendor, presidentin dhe SPAK-un. Për presidentin, dallime të mëdha u regjistruan te të anketuarit me nivel të lartë arsimor, ku të ata me diplomë universitare ishin shumë më të prirur për të thënë se u besonin institucioneve të mësipërme në krahasim me ata me nivel arsimor të mesëm e më të ulët.

Për sa i përket vendbanimit, të anketuarit që jetojnë në zonat urbane dhe rurale treguan të njëjtin nivel besimi për të gjitha institucionet, pa ndonjë dallim të madh të regjistruar ndër ta. Shih Tabelën 6 në fund të këtij kreu për ndarjen social-demografike të besimit në institucione.

BESIMI NË INSTITUCIONE, GJETJET NË VITE

Paraqitja grafike e mëposhtme, Tabela 5, tregon nivelin e besimit (ose “Kam shumë besim” ose “Kam besim”) për 17 institucione gjatë viteve 2015-2022.

Institucionet fetare janë konsideruar vazhdimisht si institucionet vendase më të besuara nga të anketuarit gjatë gjithë periudhës, ndonëse ka pasur një rënie të përgjithshme. Forcat e armatosura vijnë pas tyre, me më pak luhatje dhe një rritje e perceptimit të opinionit publik në dy vitet e fundit.

Nga ana tjetër, partitë politike, gjykatat, prokuroria dhe parlamenti janë renditur ndër institucionet më pak të besuara gjatë gjithë periudhës.

Organizatat ndërkombëtare kanë qenë vazhdimisht institucionet më të besuara, me vlerësime mbi 70% gjatë gjithë periudhës, ndonëse ky nivel besimi ka rënë që nga viti 2018.

Tabela 5: Besimi në institucione në vite (2015–2022)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Mesatare
NATO	74%	79%	84%	81%	78%	76%	73%	74%	77%
UN		80%	85%	79%	75%	76%	71%	71%	77%
BE	72%	80%	85%	80%	73%	75%	71%	71%	76%
Institucionet fetare	52%	58%	76%	73%	66%	70%	67%	64%	66%
Forcat e armatosura	46%	55%	63%	63%	59%	54%	55%	60%	57%
Sistemi arsimor	33%	59%	63%	64%	57%	54%	57%	55%	55%
Shoqëria civile	38%	46%	57%	57%	56%	53%	53%	54%	52%
Polica	46%	61%	53%	58%	55%	43%	46%	49%	51%
Media	39%	58%	54%	56%	51%	45%	48%	45%	50%
Institucionet e shëndetit publik	27%	50%	53%	54%	51%	45%	47%	47%	47%
Qeveria vendore		49%	49%	47%	42%	42%	44%	41%	45%
Qeveria qendrore	34%	44%	47%	42%	41%	36%	45%	43%	41%
Presidenti	29%	36%	33%	30%	28%	24%	24%	41%	31%
Parlamenti	22%	27%	34%	30%	28%	24%	33%	34%	29%
Gjykata			21%	28%	27%	24%	28%	36%	27%
Prokuroria			22%	28%	27%	24%	28%	33%	27%
Partitë politike	15%	23%	21%	22%	23%	20%	26%	30%	22%

Baza: N= 2500 in 2022; N= 2500 in 2021; N=2488 -2499 in 2020; N=2499 in 2019; N=1647 in 2018, 2017, 2016.

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

* Nga viti 2017 e më tej, 'Gjyqësori' është ndarë në 'Prokurori' dhe 'Gjykata'.

LEGJENDA: Ngjyrat nga e kuqja e errët në portokalli, e verdha, më pas në të gjelbër të errët shfaqin luhatje duke iu referuar shenjës 50% nga vlerat më të ulëta në ato më të larta.


REFORMA NË DREJTËSI

35% e popullsisë në Shqipëri e anketuar në këtë sondazh beson se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi, e njëjta përqindje si në 2021. Megjithatë, besimi i publikut se kjo reformë do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e vendit është ulur ndjeshëm vitin e fundit në 47%, një rënie prej -10 pp krahasuar me vitin 2021 (57%).

Reforma në drejtësi në Shqipëri nisi në vitin 2016, duke synuar të luftojë korrupsionin e përhapur dhe ndikimin politik në procesin gjyqësor. Është një nga programet më të mëdha dhe më komplekse të reformës institucionale që po ndërmerret në vend, që konsiston ndër të tjera në vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe krijimin e institucioneve të reja si Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Në vitin 2022, u evidentua se 34.6% e të anketuarve besojnë se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi, 44.8% janë kundër këtij mendimi dhe 20.7% nuk kanë një mendim. Më pak se gjysma e të anketuarve (47%) besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Rreth një e treta (32%) thanë se reforma nuk do të ketë ndikim pozitiv dhe 21% u shprehën se nuk e dinin.

Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi (2022)



Baza: Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (N=2500); Ndikimi i reformës (N=2500)


Gratë (35%) dhe burrat (34%) kishin nivele të ngjashme besimi për zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi. Të punësuarit e sektorit publik dhe ata me të ardhura mujore nga 50 001–70 000 lekë ishin shumë më të prirur se të tjerët të besonin në zbatimin me korrektësi të reformës.

Nuk kishte dallime të mëdha mes përqindjes së grave (48%) dhe burrave (46%) që besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Të anketuarit me diplomë universitare (ose pasuniversitare), punonjësit e sektorit publik dhe ata me të ardhura mujore nga 50 001-70 000 lekë prireshin më shumë të thonin se reforma do të ketë ndikim pozitiv. Për informacione më të hollësishme, shih Tabelën 7 në fund të këtij kreu.

ZBATIMI ME KORREKTËSI I REFORMËS NË DREJTËSI NË VITE

Në fillim të procesit të reformës në drejtësi në vitin 2016, të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre nëse kjo reformë do të zbatohet me korrektësi. Të dhënat treguan se gati gjysma e pjesëmarrësve të anketuar (46%) ishin optimistë, përqindje që u ul pak në 42% në 2017.


Figura 7: Besimi i publikut se reforma në drejtësi do të zbatohet me korrektësi (2016-2017)



Baza: Për zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi 2016 (N=1641); 2017 (N=1646);

Gjatë viteve 2018-2022, të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre për zbatimin e reformës që ishte në proces e sipër. Të dhënat treguan se besimi i publikut ra disi nga viti 2018 në 2020. Më pas u rikthye në të njëjtin nivel, me një rritje prej 6 pikë përqindjeje në vitin 2021 dhe ka mbetur në këtë nivel në vitin 2022.

Figura 8: Përqindja e të anketuarve që besojnë në zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi (2018-2022)



Baza: Për zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi 2018 (N=1645); 2019 (N=2498); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

PËRDORIMI I MEDIAVE

Televizioni mbetet ende burimi më popullor mediatik për gjysmën e shqiptarëve (51.3%), ku më pas kemi mediat sociale (30.6%) dhe portalet online (11.6%), që vazhdojnë rritjen si burimet kryesore të lajmeve për aktualitetin në krahasim me dy vitet e fundit.

Gjetjet e vitit 2022 tregojnë se gjysma e të anketuarve (51.3%) raportuan televizionin si burimin e tyre kryesor për lajmet për çështjet aktuale, ndjekur nga mediat sociale (30.6%), portalet online (11.6%), gazetat (4.5%) dhe radioja (1.4%).

Figura 9: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin në 2022



Baza: N =2495

*Shënim: disa të anketuar zgjedhën më shumë se një alternativë; përqindjet nuk plotësojnë totalin prej 100%

Gjetjet tregojnë se gratë (51%) dhe burrat (52%) priren të kenë perceptime të ngjashme në lidhje me përdorimin e TV si median më të preferuar. Të anketuarit e moshës 46 vjeç e lart, ata me nivel arsimor deri 8/9 vjeçar, pensionistët, ata me të ardhura mujore deri në 30,000 lekë dhe ata që banonin në zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportonin TV-në si formën e tyre të preferuar të informimit nga masmedia.

Gratë (32%) dhe burrat (30%) priren të kenë preferenca të ngjashme edhe për mediat sociale. Të anketuarit nga moshë 18 deri në 35 vjeç, ata me diplomë universitare (apo pasuniversitare), studentët dhe ata me të ardhura mujore prej 50 001 lekë e lart prireshin më shumë të përdorin platformat e mediave sociale si burim informacioni.

Referuar përdorimit të portaleve, nuk kishte dallim të madh mes grave (12%) dhe burrave (11%). Studentët dhe të anketuarit me të ardhura mbi 70 001 lekë kishin më shumë gjasa të raportonin portalet si burimin e tyre të preferuar për të marrë lajme për aktualitetin.

Ndërkohë, nuk vihen re dallime social-demografike mes atyre që preferojnë radion dhe gazetat. Për informacione më të hollësishme, shih Tabelën 8 në fund të këtij kreu.


Gjatë periudhës 2016-2022, gjetjet tregojnë se TV është parë vazhdimisht si media dominuese për të marrë lajme për çështjet aktuale, ndonëse shifrat janë ulur me kalimin e viteve duke regjistruar peshën e tij më të ulët në sondazhin e vitit 2022 (74% në 51%). Nga ana tjetër, përqindja e përdoruesve të mediave sociale është rritur nga 19% në 2016 në 31% në 2022 ndonëse me disa luhatje. Përqindja më e lartë e përdoruesve të mediave sociale u regjistrua gjatë pandemisë COVID-19 duke arritur në 36%, në vitin 2020.

SAKTËSIA E MEDIAVE

Deri në 38.6% e shqiptarëve besojnë se informacioni që jepet nga mediat në Shqipëri është i saktë/vërtetë, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2021 (38.8%).

Në vitin 2022, të anketuarit u ndanë në mënyrë të barabartë mes atyre që besojnë se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare ishte i saktë/i vërtetë (38.6%) dhe atyre që nuk e besojnë atë, me 24% të tjerë që thonë se nuk e dinë. Të anketuarit që përdorin portalet si burimin kryesor të lajmeve kishin më shumë gjasa të tregonin se informacioni i dhënë në burimin e tyre të zgjedhur ishte i saktë dhe/ose i vërtetë (33.1%), të ndjekur nga përdoruesit e TV-së (42%) dhe radios (38.9%). Nga ana tjetër, të anketuarit që raportuan se përdornin kryesisht media sociale kishin më pak gjasa të besonin në saktësinë e informacionit që jepej nga mediat (33.1%), të ndjekur nga lexuesit e gazetave (27.4%).


Figura 10: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2022



Baza: N =2495

Në vitin 2022, përqindja e të anketuarve që mendonin se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare ishte i saktë ishte e njëjtë si një vit më parë, duke kapërcyer rënien e vitit 2020. Shih Figurën 11 më poshtë.

Figura 11: Saktësia e mediave (2016-2022)



Baza: 2016 (N=1639); 2017 (N=1646); 2018 (N=1643); 2019 (N=2496); 2020 (N=2491); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500)


Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

MBËSHTETJA E DONATORËVE TË HUAJ

Pak më shumë se gjysma e shqiptarëve (51.1%) ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj (donatorëve) në Shqipëri në vitin 2022.

Pak më shumë se gjysma e shqiptarëve (51.1%) raportuan se ishin të kënaqur apo shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj (donatorëve) në Shqipëri. Nga ana tjetër, 31.3% u shprehën se ishin të pakënaqur ose aspak të kënaqur, ndërkohë që 17.6% nuk kishin mendim.

Figura 12: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri (2022)



Baza: N = 2500

Gratë (51%) dhe burrat (51%) kishin nivele të ngjashme kënaqësie (ose të kënaqura ose shumë të kënaqura me ndikimin e ndihmës së huaj). Të anketuarit e moshës 26-35 vjeç, të punësuarit në sektorin publik dhe ata me të ardhura mujore midis 50,001-70,000 lekë kishin shumë më tepër gjasa të raportonin se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndihmën e huaj.

Tabela 6: Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim')

GJITHSEJ (% e 'kam besim' dhe 'kam shumë besim')		Qeveria qendrore	Pushteti vendor	Administrata bashkiake	Këshilli bashkiak	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	SPAK	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Partitë politike	Inst. shëndetësore	Inst. arsimore	Media	Inst. fetare	OSHC-të	BE	OKB	NATO
		43%	41%	41%	37%	41%	34%	33%	50%	36%	49%	60%	30%	47%	55%	45%	64%	54%	71%	71%	74%
Gjinia																					
Gra		46%	42%	42%	38%	41%	34%	36%	50%	38%	50%	59%	29%	46%	55%	46%	65%	55%	72%	72%	74%
Burra		39%	39%	39%	36%	41%	33%	35%	50%	35%	48%	61%	30%	47%	54%	44%	64%	52%	70%	71%	75%
Mosha																					
18–25 vjeç		41%	39%	36%	35%	40%	33%	36%	49%	37%	47%	57%	33%	47%	52%	44%	61%	59%	76%	75%	77%
26–35 vjeç		44%	41%	42%	38%	44%	35%	38%	52%	40%	52%	62%	29%	46%	54%	45%	63%	54%	73%	75%	76%
36–45 vjeç		41%	40%	42%	39%	41%	36%	37%	52%	37%	49%	61%	31%	49%	58%	45%	66%	53%	70%	72%	73%
46–55 vjeç		41%	37%	39%	35%	38%	31%	34%	48%	36%	47%	57%	28%	46%	55%	46%	69%	56%	72%	73%	76%
56–65 vjeç		40%	40%	36%	34%	38%	30%	26%	44%	29%	47%	57%	24%	40%	52%	42%	59%	50%	63%	63%	69%
66 vjeç e sipër		50%	49%	51%	45%	47%	38%	38%	56%	37%	53%	62%	32%	52%	53%	50%	65%	48%	68%	65%	72%
Niveli arsimor																					
Me arsim deri 8/9-vjeçar		39%	36%	39%	34%	33%	29%	30%	42%	31%	46%	56%	28%	45%	53%	45%	65%	48%	64%	63%	66%
Me arsim të mesëm		41%	39%	41%	36%	40%	33%	35%	51%	35%	49%	59%	29%	46%	55%	44%	65%	54%	71%	72%	74%
Me arsim universitar		46%	45%	42%	40%	47%	38%	39%	54%	40%	51%	62%	31%	48%	55%	46%	63%	56%	76%	76%	79%
Statusi i punësimit																					
i/e punësuar	Gjithsej	44%	42%	43%	39%	44%	36%	37%	52%	39%	52%	63%	30%	48%	57%	44%	65%	54%	73%	74%	77%
	Sektori publik	67%	66%	63%	59%	62%	55%	55%	69%	54%	63%	74%	43%	62%	69%	56%	71%	65%	82%	85%	86%
	Sektori privat	35%	32%	35%	31%	37%	29%	31%	47%	33%	46%	59%	25%	43%	53%	40%	62%	51%	70%	71%	74%
I/e papunë		36%	35%	36%	33%	33%	27%	30%	44%	31%	45%	54%	28%	44%	52%	47%	66%	53%	68%	68%	71%
Student		41%	36%	32%	32%	40%	30%	35%	47%	32%	42%	51%	33%	45%	49%	48%	66%	59%	75%	75%	77%
Pensionist		49%	46%	46%	41%	45%	36%	35%	52%	33%	50%	59%	28%	45%	50%	46%	62%	48%	64%	61%	67%
Vendbanimi																					
Urban		43%	39%	39%	37%	42%	34%	37%	51%	37%	50%	62%	30%	46%	55%	46%	63%	54%	72%	72%	75%
Rural		42%	43%	44%	38%	39%	33%	32%	47%	34%	47%	55%	28%	47%	53%	44%	66%	53%	69%	70%	73%
Niveli i të ardhurave																					
Pa të ardhura		36%	34%	32%	32%	34%	26%	28%	43%	30%	43%	52%	26%	42%	50%	46%	65%	54%	70%	70%	71%
Deri në 30,000 lekë		45%	42%	44%	38%	40%	34%	34%	51%	35%	49%	59%	32%	48%	52%	48%	63%	52%	67%	64%	69%
30,001–50,000 lekë		45%	43%	45%	41%	44%	36%	37%	54%	40%	53%	63%	30%	47%	60%	42%	66%	55%	74%	75%	77%
50,001–70,000 lekë		49%	47%	48%	43%	51%	42%	46%	58%	44%	53%	66%	35%	51%	60%	49%	64%	58%	77%	80%	80%
Mbi 70,001 lekë		40%	35%	34%	29%	42%	35%	31%	48%	31%	56%	71%	23%	50%	47%	38%	63%	46%	71%	71%	81%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 7: Ndarja demografike e reformës në drejtësi (2022)

	Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi (% po)	Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (% po)
Gjithsej		
Gjinia		
Gra	48%	35%
Burra	46%	34%
Mosha		
18-25 vjeç	47%	33%
26-35 vjeç	51%	36%
36-45 vjeç	46%	36%
46-55 vjeç	46%	33%
56-65 vjeç	43%	31%
Mbi 66 vjeç	48%	38%
Niveli arsimor		
Me arsim deri 8/9-vjeçar	42%	31%
Me arsim të mesëm	44%	33%
Me arsim universitar	53%	39%
Statusi i punësimit		
Gjithsej	50%	37%
I/e punësuar		
Sektori publik	66%	56%
Sektori privat	45%	31%
I/e papunë	41%	30%
Studentë	45%	30%
Pensionist	44%	34%
Niveli i të ardhurave		
Pa të ardhura	41%	28%
Deri në 30,000 lekë	46%	35%
30,001 – 50,000 lekë	51%	39%
50,001–70,000 lekë	55%	42%
Mbi 70,001 lekë	46%	29%
Vendbanimi		
Urban	48%	35%
Rural	45%	33%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 8: Ndarja demografike e përdorimit të mediave (2022)

Gjithsej	Burimi mediatik më i përdorur				
	TV	Radio	Gazeta	Portalet	Mediat sociale
Gjinia					
Gra	51%	1%	4%	12%	32%
Burra	52%	2%	5%	11%	30%
Mosha					
18-25 vjeç	25%	0%	6%	17%	52%
26-35 vjeç	34%	1%	4%	17%	44%
36-45 vjeç	49%	1%	4%	14%	31%
46-55 vjeç	66%	1%	4%	7%	21%
56-65 vjeç	74%	2%	5%	5%	14%
Mbi 66 vjeç	76%	3%	8%	3%	9%
Niveli arsimor					
Me arsim deri 8/9-vjeçar	64%	3%	6%	6%	20%
Me arsim të mesëm	56%	1%	4%	10%	28%
Me arsim universitar	38%	1%	4%	16%	40%
Statusi i punësimit					
Gjithsej	47%	1%	4%	13%	34%
Të punësuar					
Sektori publik	45%	1%	4%	15%	35%
Sektori privat	48%	1%	4%	15%	34%
I/E papunë	55%	1%	5%	10%	27%
Student	24%	1%	5%	20%	49%
Pensionist	78%	4%	6%	2%	9%
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura	50%	1%	4%	11%	33%
Deri në 30,000 lekë	63%	2%	5%	8%	20%
30,001–50,000 lekë	50%	1%	4%	11%	33%
50,001–70,000 lekë	42%	2%	5%	15%	37%
Mbi 70,001 lekë	34%	1%	5%	22%	39%
Vendbanimi					
Urban	48%	1%	5%	12%	33%
Rural	58%	2%	4%	10%	25%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.2 TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementët më të rëndësishëm për funksionimin e duhur të demokracisë. Ato plotësojnë njëra-tjetrën dhe u bëjnë të mundur qytetarëve të ndikojnë në procesin vendimmarrës dhe t'u kërkojnë llogari pushtetarëve. Kombet e Bashkuara njohin rëndësinë e ndërtimit të institucioneve të përgjegjshme dhe transparente si pjesë e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Objektivi 16 synon promovimin e shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimin e aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimin e institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet, kurse Objektivi 16.6. fokusohet te zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet¹.

Transparencë do të thotë që qeveria vepron në mënyrë të hapur. Kjo përfshin dhënien e informacionit të saktë për veprimtarinë dhe shpenzimet e saj dhe për vendimet që merr. Element kyç i transparencës është e drejta për akses tek informacioni që prodhohet nga autoritetet publike, duke qenë se një gjë e tillë bën të mundur që institucionet publike vendimmarrëse të jenë të hapura për publikun².


Nga ana tjetër, llogaridhënia kërkon që qeveria të marrë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e saj. Ajo ka dy dimensione: përgjegjësia për t'u përgjigjur – ose detyrimi i autoriteteve publike për t'i dhënë publikut informacione dhe shpjegime për veprimtaritë e tyre; dhe zbatimi ose mekanizmat, me anë të të cilave informacioni që merret mund të sigurojë që qeveria merr masa për çdo dështim. Llogaridhënia mund të jetë vertikale (drejtpërdrejtë me publikun) ose horizontale (që mundësohet nëpërmjet mekanizmave që veprojnë ndërmjet institucioneve publike).³

TRANSPARENCA

Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar e konsideronin qeverinë qendrore (59.4%) dhe bashkinë (60.2%) si jotransparente, në vlera të përafërta me vitin 2021.

Të dhënat e vitit 2022 nxjerrin në pah mungesë besimi në transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore. Më shumë se gjysma e të anketuarve (59.4%) 'nuk ishin dakord' ose 'nuk ishin aspak dakord' me deklaratën se qeveria qendrore është transparente. Vetëm 38.7% e të anketuarve ishin plotësisht dakord ose dakord se qeveria qendrore është transparente. 60.2% e të anketuarve nuk ishin dakord me deklaratën "Bashkia është transparente", ndërkohë vetëm 37% ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë deklaratë.

Figura 13: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore (2022)



Baza: Qeveria qendrore (N=2500); qeveria vendore (N=2500)

1 Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2019). Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Vizitoni: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/>

2 Shpjegimi i koncepteve bazohet kryesisht në kumtesën "Standardet Ndërkombëtare për Transparencën dhe Llogaridhënien". Qendra për Ligj dhe Demokraci (2014). Marrë nga adresa: http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_Mar14.pdf

3 Po aty.

Në përgjithësi, ka pasur disa ndryshime në perceptim bazuar në të dhënat social-demografike për gjininë, arsimin, punësimin dhe të ardhurat. Megjithatë, dallimet ishin përgjithësisht të vogla, ku pjesa më e madhe e grupeve dhanë vlerësime që luhaten në nivelet 35% dhe 47%.

Të dyja gjinitë kishin perceptime të ngjashme për transparencën e qeverisë qendrore dhe bashkive të tyre. Për sa i përket moshës, nuk kishte ndonjë dallim të konsiderueshëm. Gjithsesi, vlen të theksohet se të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç kishin një përqindje relativisht më të lartë të perceptimit të transparencës. Në këtë grup-moshë, 47% e të anketuarve e konsiderojnë qeverinë qendrore ashtu edhe bashkinë e tyre si transparente.

Të anketuarit me diplomë universitare kishin perceptimin më të lartë të transparencës, si për qeverinë qendrore ashtu edhe për atë të nivelit vendor. Ata me arsim deri 8/9 vjeçar shënuan nivelet më të ulëta perceptimit për transparencën.

Të anketuarit e punësuar, qoftë në sektorin publik apo privat, kishin një perceptim më të lartë të transparencës krahasuar me të anketuarit e papunë dhe studentët. Ndërkohë, punonjësit e sektorit publik prireshin më shumë të mendonin se qeveria është transparente në krahasim me të anketuarit në sektorin privat.

Të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë kishin një ndjesi më të ulët për transparencën e qeverisë, veçanërisht për atë në nivel vendor. Ata me të ardhura nga 50 001-70 000 lekë shënuan vlerësimet më të larta si në nivel qendror ashtu edhe në vendor të qeverisjes.


Të anketuarit nga zonat rurale kishin besim më të madh në transparencën si të qeverisë qendrore ashtu edhe të bashkisë së tyre krahasuar me të anketuarit e zonave urbane, ndonëse dallimi në perceptim ishte minimal.

USHTRIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM

Shumica e shqiptarëve të anketuar (65.3%) ishin në dijeni për të drejtën e tyre për informim. Në mënyrë të veçantë, grupmosha 26-35 vjeç (78.9%), ata me diplomë universitare (78.8%), të punësuarit (70.9%), studentët (75.3%) dhe të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore mbi 70 001 lekë (79.4%) treguan se ishin të informuar për këtë të drejtë.

Është me rëndësi tejet të madhe të vlerësohet ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e tyre për informim si një nga pikat kryesore të programeve të transparencës. Miratimi i Ligjit Nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit" ishte një nga hapat më domethënës të ndërmarrë drejt përmirësimit të transparencës. Ky ligj parashikon të drejtën e marrjes së informacionin që prodhohet ose mbahet nga institucionet publike. Ai parashikon se çdokush ka të drejtë të marrë informacione publike pa pasur nevojë të shpjegojë arsyen përse e ka kërkuar atë.

Sipas rezultateve të sondazhit, shumica (65.3%) e të anketuarve treguan se ishin në dijeni që ligji u garantonte të drejtën e informimit, duke reflektuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2021 (62%). Nga ana tjetër, 34.7% e të anketuarve nuk ishin në dijeni të kësaj të drejte.

Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit (2022)

Baza: N=2396

Analiza demografike e të dhënave nxjerr në pah se nuk kishte dallime të mëdha gjinore për sa i përket ndërgjegjësimit për të drejtën e informimit në Shqipëri, ku kemi 64.2% e grave dhe 66.5% e burrave.

Ndërgjegjësimi për të drejtën e informimit ndryshonte në kategori të tjera demografike si grupmosha, niveli arsimor, vendbanimi dhe niveli i të ardhurave. Të anketuarit në moshë më të re duket se janë më të informuar për këtë të drejtë në krahasim me të anketuarit në moshë më të madhe.


Të anketuarit nga moshja 26 deri në 35 vjeç (78,9%), të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (78,8%), të punësuarit (70,9%), studentët (75,3%), ata që banojnë në zonat urbane (67,2%), dhe të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore mbi 70,001 lekë (79,4%) prireshin më shumë të evidentonin se ishin në dijeni për këtë të drejtë në krahasim me grupet e tjera demografike.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë luhatje të nivelit të ndërgjegjësimit për të drejtën e informimit ndër vite. Viti 2019 kishte përqindjen më të lartë të të anketuarve (67%) që ishin në dijeni të kësaj garancie ligjore. Megjithatë, pati një rënie të lehtë në vitin 2020 (64%), e ndjekur nga një rënie e mëtejshme në 2021 (62%). Është interesante se ndërgjegjësimi i raportuar u rrit pak në vitin 2022 në 65% të të anketuarve.

LLOGARIDHËNIA

Një shumicë e konsiderueshme e shqiptarëve mendonin se as qeveria qendrore dhe as qeveria vendore nuk japin llogari. Vetëm 36% e të anketuarve thanë se e konsiderojnë qeverinë qendrore të përgjegjshme, ndërsa 37.8% e konsiderojnë bashkinë e tyre si të përgjegjshme, njësoj si në vitin 2021 (37.5% dhe 38.6% respektivisht). Të anketuarit me nivele më të larta të ardhurash, të papunët dhe të anketuarit e punësuar në sektorin privat ishin më të pakët në përqindje që konsideronin qeverinë qendrore dhe atë vendore si të përgjegjshme.

Një pjesë e madhe (62.1%) e të anketuarve nuk mendojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme. Kjo shifër përbën 39.7% të të anketuarve të cilët në përgjithësi nuk ishin dakord me pohimin “Qeveria qendrore është e përgjegjshme (jep llogari)”, ndërkohë që 22.4% të tjerë që nuk ishin aspak dakord. Po ashtu, 59.8% e të anketuarve janë shprehur se nuk mendojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme, me 37.7% që nuk ishin dakord dhe 22.1% që nuk ishin aspak dakod.

Figura 15: Perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore dhe vendore (2022)

Baza: Qeveria qendrore (N=2500); qeveria vendore (N=2500)

Një ndryshim relativisht i vogël vihet re perceptimin e kërkesës së llogarisë midis të anketuarve gra dhe burra. Te gratë, 37% besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme, ndërsa 38% tyre mendojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme. Te burrat, 35% besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme, ndërsa 37% kanë këtë mendim për bashkinë e tyre.

Grupmosha më e re (18-25 vjeç) kishte perceptimin më të ulët të llogaridhënies, me vetëm 32% të tyre që besonin se qeveria qendrore është përgjegjshme dhe 36% për bashkinë. Të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç kishin perceptimin më të lartë për llogaridhënien, ku 43% e tyre besonin se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 46% besojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme.

Të anketuarit me diplomë universitare kishin perceptimin më të lartë të llogaridhënies sipas nivelit të arsimit, (38% për qeverinë qendrore dhe 40% për bashkinë). Të anketuarit me arsim deri 8/9 vjeçar shënuan nivel më të ulët të këtij perceptimi, ku 32% e tyre besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 33% besojnë këtë gjë për bashkinë e tyre. Të anketuarit në marrëdhënie pune kishin më shumë gjasa ta konsideronin qeverinë si të përgjegjshme krahasuar me të anketuarit e papunë dhe studentët, 38% e të cilëve besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 40% besojnë se bashkia e tyre është e përgjegjshme. Të dhënat tregojnë një dallim të madh mes perceptimit të punonjësve të sektorit publik dhe privat, ku shumica e të punësuarve në sektorin publik kanë një perceptim pozitiv të llogaridhënies për të dy nivelet (59% për qeverinë qendrore dhe 62% për bashkinë). Nga ana tjetër, vetëm 29% e punonjësve të sektorit privat mendojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 31% kanë këtë mendim për bashkinë e tyre.

Të anketuarit me nivelet më të larta të të ardhurave (mbi 70,001 lekë) kishin një perceptim më të ulët të llogaridhënies në krahasim me grupet e tjera të të ardhurave, ku vetëm 35% e tyre mendojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 26% kanë këtë perceptim për bashkinë e tyre.

Të anketuarit nga zonat rurale kishin besim më të madh në përgjegjshmërinë e qeverisë në krahasim me të anketuarit nga zonat urbane. Mes të anketuarve në zonat rurale, 38% besojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 41% kanë këtë mendim për bashkinë e tyre. Shih Tabelën 9 në fund të këtij kreu për ndarjen e plotë sipas grupeve demografike.


TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE NË VITE

Më pak se gjysma e të anketuarve mes viteve 2016-2022 e konsiderojnë qeverinë qendrore dhe vendore si transparente ose të përgjegjshme. Perceptimi publik si për transparencën ashtu edhe për llogaridhënien është luhatur në nivele ngjashme.

Që nga viti 2016, qeveria vendore vendor është vlerësuar vazhdimisht pak më e përgjegjshme se niveli qendror, me një mesatare prej 38% krahasuar me 35%. Megjithatë, në vitin 2019 për nivelin vendor të qeverisjes u vu re një rënie e dukshme prej 7 pp. Nga ana tjetër, qeveria qendrore perceptohet si më transparente, me një vlerësim mesatar prej 40% krahasuar me 37% për qeverisjen vendore. Gjithsesi, në rastin më të mirë, vlerësimet mbeten nën 45%.


Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se ka pasur luhatje në perceptimin për transparencën dhe llogaridhënien për të dy nivelet e qeverisjes në vitet 2016-2022. Ndërkohë që në disa vite ka pasur përmirësime, në vitet e tjera vlerësimi për transparencën dhe llogaridhënien ka pësuar rënie të lehta.

Figura 16: Transparenca dhe llogaridhënia institucionale (2016-2022)



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1647); 2017 (N=1636); 2018 (N=1644); 2019 (N=2492); 2020 (N=2495); 2021 (N=2500) dhe qeveria vendore: 2016 (N=1645); 2017 (N=1637); 2018 (N=1642); 2019 (N=2489); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1646); 2017 (N=1635); 2018 (N=1644); 2019 (N=2491); 2020 (N=2495); 2021 (N=2500), dhe qeveria vendore: 2016 (N=1645); 2017 (N=1633); 2018 (N=1643); 2019 (N=2485); 2020 (N=2489); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500).


Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

LLOGARIDHËNIA HORIZONTALE DHE VERTIKALE

Në vitin 2022, organizatat ndërkombëtare vazhduan të konsideroheshin si institucionet më kryesore që i kërkonin llogari qeverisë, ndonëse me një rënie prej 7 pikë përqindje nga viti 2021. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbeti institucioni vendas që konsiderohej nga anketuarit se luan më shumë rol për t'i kërkuar llogari qeverisë (63.4 %), ndjekur nga parlamenti (58.4%) dhe media (55%), edhe pse me rënie për KLSH-në (-8 pp), për parlamentin (-6 pp) dhe mediat (-6.5 pp) krahasuar me vitin 2021.

Llogaridhënia horizontale ushtrohet me anë të një rrjeti institucioneve dhe ka të bëjë me kapacitetet e institucioneve shtetërore, të tillë si parlamenti dhe gjyqësori, për të mbikëqyrur politikën e qeverisë duke i kërkuar asaj informacione, duke kontrolluar zyrtarët dhe duke ndëshkuar shkeljet apo sjelljet e gabuara. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale i referohet marrëdhënieve mes institucioneve dhe qytetarëve. Kjo ka të bëjë me instrumentet me të cilat qytetarët, masmedia, dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë nga zyrtarët e qeverisë.

Ndër mekanizmat në vend për llogaridhënien horizontale, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) vazhdon të konsiderohet si institucioni më efikas (63.4%), i ndjekur nga parlamenti (58.4%) dhe Avokati i Popullit (50.9%), ndonëse me një rënie për KLSH-në (me -8 pp) dhe për Parlamentin (me -6 pp). Nga ana tjetër, deputetët të veçantë (48%), partitë opozitare (46.2%), Komisioneri Kundër Diskriminimit (49.3%) dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (49%) janë vlerësuar si më pak efektive në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale (2022)


Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

Ndarja demografike nxori në pah ndryshime të vogla, në mos asnjë ndryshim, mes grupe të ndryshme demografike. Në të gjitha kategoritë demografike, KLSH shihej si organi më efikas për kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Gratë përgjithësisht i vlerësuan institucionet e listuara si më efektive se burrat. Të anketuarit me diplomë universitare vazhdimisht kanë dhënë vlerësime më të larta për efektivitetin në të gjitha institucionet e listuara, ndërsa ata me nivel arsimor 8/9-vjeçar në përgjithësi kanë dhënë vlerësime të ulëta.

Ashtu si edhe vitin e kaluar, të punësuarit në sektorin publik prireshin më shumë të mendonin se të gjitha institucionet e listuara (parlamenti, 69%; deputetë të veçantë, 54%; KLSH, 73%; partitë e opozitës, 53%; Avokati i Popullit, 59%; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, 61% dhe Komisioneri Kundër Diskriminimit, 62%) i kërkojnë llogari qeverisë krahasuar me ata që punojnë në sektorin privat. Nuk ka një ndarje të qartë bazuar në nivelin e të ardhurave të të anketuarve. Megjithatë, të anketuarit në grupin e të ardhurave 50,001-70,000 lekë priren të kenë perceptime më të larta për llogaridhënien në pjesën më të madhe të institucioneve.

Në lidhje me mekanizmat e brendshëm të llogaridhënies vertikale, media u konsiderua se luante rolin më të rëndësishëm në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë, me 55% të të anketuarve që kishin këtë mendim. Më pas vinin sindikatat (50%), organizatat e shoqërisë civile (48.8%) dhe bizneset apo shoqatat e tyre (47.2%). Gjithsesi, ka pasur një rënie statistike të konsiderueshme prej 6.5 pp në perceptimin e rolit të medias krahasuar me vitin 2021. Nga ana tjetër, një shumicë e madhe e të anketuarve (70.4%) besojnë se organizatat ndërkombëtare e bëjnë qeverinë të japë llogari, ndonëse ky opinion ka pësuar një rënie me 7 pikë përqindje krahasuar me vitin 2021. Për të gjitha gjetjet sipas ndarjes social-demografike, shih Tabelën 9 në fund të këtij kreu.

Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale (2022)

Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

Në të gjitha kategoritë demografike, mediat dhe organizatat ndërkombëtare u perceptuan më shpesh se i kërkonin llogari qeverisë.

Si burrat ashtu edhe gratë e shihnin median (54% dhe 56%) si institucionin më efikas në këtë drejtim, ndjekur nga organizatat e shoqërisë civile (51% dhe 47%).

Gratë treguan një nivel pak më të lartë besim tek organizatat ndërkombëtare (71%) krahasuar me burrat (70%). Grupmosha 36-45 vjeç kishte perceptimin më të lartë të llogaridhënies për organizatat e shoqërisë civile (51%), e ndjekur nga afër nga grupmosha 26-35 (50%).

Grupmosha 18-25 vjeç kishte besimin më të madh në rolin e organizatave ndërkombëtare (73%), ndërsa grupmosha 56-65 vjeç shprehu nivelin më të ulët të besimit (69%). Nëse i krahasojmë sipas nivelit arsimor, të anketuarit me diplomë universitare dhanë vlerësimet më të larta për organizatat e shoqërisë civile (50%) dhe organizatat ndërkombëtare (74%).

Të anketuarit me arsim të mesëm u shprehën se kishin besim më të madh te media (53%). Të punësuarit e sektorit publik dhanë vlerësimet më të larta të llogaridhënies për të gjitha institucionet e listuara, veçanërisht për organizatat e shoqërisë civile (59%) dhe organizatat ndërkombëtare (80%).

Të punësuarit në sektorin privat ishin në përgjithësi më pak të sigurt për sa i përket llogaridhënies së institucioneve krahasuar me të punësuarit në sektorin publik, ku mediat ishin organi më efikas për ta (54%). Të anketuarit me nivele më të larta të ardhurash prireshin të kishin një perceptim më të lartë për efektivitetin e të gjitha institucioneve të listuara. Kjo vihet re veçanërisht tek ata të anketuar që kishin të ardhura të rregullta mujore mbi 70,001 lekë, të cilët vlerësuan organizatat ndërkombëtare (77%) si më efikase. Si banorët e zonave urbane ashtu edhe ato rurale kishin perceptime të ngjashme për institucionet e listuara, ku mediat dhe organizatat e shoqërisë civile shiheshin si më efektive në aspektin e llogaridhënies. Për një ndarje të plotë sipas karakteristikave social-demografike të përgjigjeve shih Tabelën 10 në fund të këtij kreu.

LLOGARIDHËNIA HORIZONTALE DHE VERTIKALE NË VITE

Analiza e viteve të mëparshme nxjerr në pah nivele të ndryshme mes institucioneve të listuara. Ndërkohë që perceptimet e disa institucioneve kanë qenë të qëndrueshme, të tjerat kanë përjetuar luhatje ose rënie.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u raportua si mekanizmi i brendshëm më efektiv për llogaridhënien horizontale nga më shumë se gjysma e të anketuarve, me një vlerësim mesatar prej 64% nga viti 2016 deri në vitin 2022. Parlamenti e ndjek nga afër me një mesatare prej 56%.

Organizatrat ndërkombëtare konsiderohen se luajnë një rolë më efektiv se organizatat shqiptare nga pjesa më e madhe e të anketuarve gjatë periudhës 2016-2022 (me një vlerësim mesatar prej 73%). Media u raportua si mekanizmi më efektiv i llogaridhënies së brendshme nga më shumë se gjysma e të anketuarve për sa i përket llogaridhënies vertikale, me një vlerësim mesatar prej 59% në këtë periudhë.

Efektiviteti i deputetëve si individë për llogaridhënien e qeverisë ka mbetur relativisht i qëndrueshëm, me vlerësimin më të lartë të shënuar në vitin 2017 (54%). Po ashtu, i qëndrueshëm ka mbetur edhe vlerësim për efektivitetin e perceptuar të partive të opozitës në rreth 46-47% gjatë viteve në shqyrtim, duke arritur sërish kulmin në vitin 2017 (54%).

Efektiviteti i perceptuar i Avokatit të Popullit ka pësuar luhatje gjatë viteve në fjalë, ndërsa Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave dhe Komisioneri Kundër Diskriminimit kanë pasur rritje graduale me kalimin e viteve. Organizatat e shoqërisë civile kanë mbajtur një nivel të qëndrueshëm me një mesatare prej 48%.

Edhe perceptimi për bizneset apo shoqatat e tyre si mekanizma efektivë të llogaridhënies ka mbetur relativisht i qëndrueshëm, me një mesatare prej 44%. Po ashtu, sindikatat kanë pasur një nivel mjaft të qëndrueshëm perceptimi, por me një rritje gjatë viteve në fjalë.

Tabela 9: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2022)

	Qeveria qendrore është transparente.	Bashkia është transparent	Qeveria qendrore është e përgjegjshme.	Bashkia është e përgjegjshme.	
Gjithsej	39%	38%	36%	38%	
Gjinia					
Gra	40%	38%	37%	38%	
Burra	37%	37%	35%	37%	
Mosha					
18-25 vjeç	37%	37%	32%	36%	
26-35 vjeç	39%	37%	37%	39%	
36-45 vjeç	40%	39%	37%	40%	
46-55 vjeç	36%	35%	35%	34%	
56-65 vjeç	36%	35%	34%	33%	
Mbi 66 vjeç	47%	47%	43%	46%	
Niveli arsimor					
Me arsim deri 8/9-vjeçar	35%	34%	32%	33%	
Me arsim të mesëm	38%	38%	36%	39%	
Me arsim universitar	41%	39%	38%	40%	
Statusi i punësimit					
I/e punësuar	Gjithsej	40%	39%	38%	40%
	Sektori publik	61%	60%	59%	62%
	Sektori privat	31%	30%	29%	31%
I/E papunë	33%	31%	29%	29%	
Student	37%	38%	34%	41%	
Pensionist	45%	44%	40%	42%	
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura	33%	31%	29%	31%	
Deri në 30,000 lekë	40%	40%	37%	38%	
30,001-50,000 lekë	40%	37%	37%	40%	
50,001-70,000 lekë	47%	47%	46%	48%	
Mbi 70,001 ALL	37%	29%	35%	26%	
Vendbanimi					
Urban	38%	36%	35%	36%	
Rural	41%	41%	38%	41%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 10: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale (2022)

	Parlamenti	Deputetë të veçantë	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Komisioneri për të Drejtën e Informimit	Organizatet e shoqërisë civile	Media	Bizneset / shoqata biznesi	Sindikatat	Organizatet ndërkombëtare
Gjithsej (%për llogaridhënien)	58%	48%	63%	46%	51%	49%	49%	49%	55%	47%	50%	70%
Gjinia												
Burra	56%	47%	61%	44%	48%	46%	48%	51%	54%	47%	52%	70%
Gra	60%	49%	66%	48%	53%	52%	51%	47%	56%	47%	48%	71%
Mosha												
18-25 vjeç	57%	46%	62%	45%	49%	51%	51%	47%	51%	46%	54%	73%
26-35 vjeç	61%	49%	68%	48%	51%	50%	49%	50%	57%	47%	50%	71%
36-45 vjeç	62%	50%	65%	48%	52%	47%	51%	51%	56%	51%	53%	74%
46-55 vjeç	55%	46%	59%	43%	51%	47%	49%	48%	55%	46%	49%	68%
56-65 vjeç	52%	46%	60%	44%	50%	48%	45%	47%	53%	43%	42%	69%
Mbi 66 vjeç	62%	51%	64%	49%	54%	51%	50%	46%	59%	50%	52%	65%
Niveli arsimor												
Me arsim deri 8/9-vjeçar	52%	44%	57%	44%	46%	44%	45%	45%	57%	45%	46%	61%
Me arsim të mesëm	59%	49%	62%	47%	51%	48%	48%	49%	53%	48%	51%	73%
Me arsim universitar	62%	49%	68%	46%	54%	53%	53%	50%	56%	47%	52%	74%
Statusi i punësimit												
I/E punësuar	Gjithsej	60%	49%	65%	47%	51%	50%	50%	54%	48%	50%	74%
	Sektori publik	69%	54%	73%	53%	59%	61%	62%	60%	52%	59%	80%
	Sektori privat	55%	46%	62%	44%	48%	45%	46%	52%	47%	48%	71%
I/E papunë	55%	46%	59%	46%	48%	46%	48%	47%	59%	46%	48%	65%
Student	58%	46%	64%	44%	54%	55%	57%	51%	56%	50%	61%	73%
Pensionist	58%	49%	63%	47%	53%	51%	48%	48%	55%	46%	49%	64%
Niveli i të ardhurave												
Pa të ardhura	57%	46%	61%	45%	51%	49%	50%	46%	57%	46%	51%	66%
Deri në 30,000 lekë	57%	46%	59%	47%	51%	47%	47%	51%	59%	49%	51%	68%
30,001-50,000 lekë	61%	50%	66%	46%	52%	49%	51%	51%	50%	48%	52%	73%
50,001-70,000 lekë	61%	52%	69%	49%	53%	56%	54%	54%	57%	49%	55%	80%
Mbi 70,001 ALL	58%	50%	63%	40%	54%	48%	48%	36%	50%	46%	41%	77%
Vendbanimi												
Urban	57%	48%	64%	46%	51%	50%	50%	49%	55%	45%	51%	72%
Rural	60%	47%	62%	47%	51%	47%	47%	49%	56%	51%	47%	68%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.3 KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Korrupsioni –abuzimi i postit publik për përfitime private– klasifikohet në korrupsion i vogël (korrupsion i nivelit të ulët) dhe korrupsion i madh (korrupsion i nivelit të lartë). Korrupsion i nivelit të ulët i referohet abuzimit të pushtetit që i është besuar një zyrtari publik në marrëdhëniet me qytetarët; ndërkohë që korrupsion i nivelit të lartë është abuzimi i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grupi të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë.


Çdo vit, në sondazh janë bërë të njëjtat pyetje për të matur nivelin e përhapjes së korrupsionit nivelit të lartë dhe të ulët, nivelin e besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël dhe të madh; nëse të anketuarit kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsionit në institucionet publike; cilin institucion rendisin si më të korruptuar; nëse të anketuarit kanë marrë shërbime prej qeverisë qendrore apo vendore; dhe nëse kanë paguar rryshfetin tek ndonjë nëpunës publik.

PERCEPTIMET PËR PËRHAPJEN E KORRUPSIONIT

Në vitin 2022, shumica e të anketuarve mendojnë se korrupsioni i nivelit të ulët është ‘i përhapur’ dhe ‘shumë i përhapur’, krahasuar me 79.1% që kanë këtë mendim për korrupsionin e nivelit të lartë. Nga viti 2021, është ulur përqindja e të anketuarve që mendonin se korrupsioni është ‘i përhapur’ dhe ‘shumë i përhapur’ për të dyja nivelet e korrupsionit, veçanërisht për atë të nivelit të ulët (-6 pp nga 2021 dhe -10 pp nga 2019 dhe 2020). Të anketuarit u pyetën për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit në një shkallë me katër pikë nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). U bënë krahasime mes korrupsionit të nivelit të ulët dhe atij të lartë.

Shifrat për vitin 2022 nxjerrin në pah se pjesa më e madhe e të anketuarve (76.5%) raportuan se korrupsioni i vogël është “i përhapur” ose “shumë i përhapur”. Ndërkohë që vetëm 17.7% raportuan se nuk është i përhapur ose aspak i përhapur. Në lidhje me korrupsionin e madh, 79.1% e të anketuarve e konsideronin atë si “të përhapur” ose “shumë të përhapur”, dhe 19.2% mendojnë se nuk është i përhapur ose aspak i përhapur.

Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2022)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N=2500); Korrupsioni i nivelit të ulët (N=2500).

Nga gjetjet e sondazhit konstatohet se një përqindje e ngjashme e grave (76%) dhe burrave (77%) e konsiderojnë korrupsionin e vogël si të përhapur ose shumë të përhapur. Të anketuarit që punojnë në sektorin privat dhe ata me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë prireshin më shumë gjasa të deklaronin se korrupsioni i vogël është i përhapur ose shumë i përhapur. Për korrupsionin e madh, e njëjta përqindje e grave (79%) dhe burrave (79%) raportuan se ai është i përhapur ose shumë i përhapur. Të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë ishin më shumë të prirur të thonin se korrupsioni i madh është ose i përhapur ose shumë i përhapur.


Edhe një herë, në edicionin e dhjetë të sondazhit të opinionit publik, të anketuarit u pyetën për perceptimin e tyre për institucionet më të korruptuara. Pesë institucionet që u përmendën më shpesh prej tyre në vitin

2022 ishin institucionet e sistemit gjyqësor (20.6%), institucionet e kujdesit shëndetësor (18%), policia (7%), institucionet e nivelit vendor (6.8%)¹ dhe ministritë (4.7%).

PËRHAPJA E KORRUPSIONIT NË VITE

Kur analizojmë përgjigjet për përhapjen e korrupsionit gjatë periudhës 2019-2022, gjetjet tregojnë se pjesa dërrmuese e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin e madh ashtu edhe atë të vogël si “të përhapur” dhe “shumë të përhapur”, me vlerësime mbi 77%. Rënie e dukshme është regjistruar në perceptimin për përhapjen e korrupsionit të vogël në vitin 2022 (-6 pp nga 2021 dhe -10 pp nga 2019 dhe 2020).

Figura 20: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit ‘I përhapur’ ose ‘Shumë i përhapur’ (2019 – 2022)



Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët, 2019 (N=2494); 2020 (N=2499); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500); Korrupsioni i nivelit të lartë, 2019 (N=2495); 2020 (N=2499); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500)

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

BESIMI NË NDJEKJEN PENALE TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT


Në vitin 2022, 65.8% e të anketuarve nuk kishin besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë, ndërsa 56.9% nuk kishin besim në ndjekjen penale efektive të korrupsionit të vogël. Niveli i mosbesimit është në nivele të ngjashme me vitin 2021, përkatësisht 68.4% dhe 59.3%. Përveç përhapjes së korrupsionit, të anketuarve iu kërkua të thonin sa besim kishin në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, edhe kjo në një shkallë prej 4 pikësh: nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Edhe këtu u bë një dallim mes korrupsionit të vogël dhe korrupsionit të madh.

Gjetjet e sondazhit të vitit 2022 tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve (56.9%) nuk kishin besim në ndjekjen efektive të korrupsionit të vogël, ndërsa, 34.1% raportuan se “kanë besim” dhe 7% se “kanë shumë besim”.

Për sa i përket korrupsionit të madh, rezultatet tregojnë se 65.8% e të anketuarve të këtij sondazhi ose “nuk kanë besim” ose “nuk kanë aspak besim” në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Nga ana tjetër, 25.6%

raportuan se “kanë besim” dhe vetëm 6.4% thanë se “kanë shumë besim”.

Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2022)



Baza: Korrupsioni i madh (N=2500); Korrupsioni i vogël (N=2500).

Nuk pati dallime në përqindjet e grave dhe burrave (nga 57% përkatësisht) që nuk ishin të sigurt në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël. Të anketuarit me arsim deri 8/9-vjeçar, studentët apo personat e papunë dhe ata që punojnë në sektorin privat ishin më pak të sigurt në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël në krahasim me kategoritë e tjera demografike.


Perceptimet e grave (65%) dhe burrave (66%) nuk ndryshojnë as për sa i përket ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit të madh. Të dy gjinitë shprehën nivele të ulëta besimi. Të anketuarit e papunë dhe ata që punojnë në sektorin privat ishin më pak të sigurt në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh.

BESIMI NË NDJEKJEN PENALE TË RASTEVE TË KORRUPSIONIT, GJETJET NË VITE

Siç tregohet edhe në Figurën 22, pavarësisht luhatjeve në vite, besimi i të anketuarve në ndjekjen penale të korrupsionit të madh dhe atij të vogël është përmirësuar, ndonëse me rritje mjaft të vogla. Në fakt, më pak se një e treta e të anketuarve raportuan se kishin besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh, gjatë viteve 2017-2022 (vlerësimet që varionin në 25-32%).

Gjatë gjithë periudhës, të anketuarit kishin vazhdimisht besim më të madh në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël krahasuar me korrupsionin e madh (nivele që luhateshin në 32%-41%). Pavarësisht luhatjeve në vite, besimi i të anketuarve në ndjekjen penale të korrupsionit të madh dhe atij të vogël është përmirësuar në përgjithësi, edhe pse me diferencë të vogël.

Figura 22: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017-2018)



Baza: Korrupsioni i madh: 2017 (N=1639); 2018 (N=1644); 2019 (N=2490); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500).
Korrupsioni i vogël: 2017 (N=1639); 2018 (N=1644); 2019 (N=2461); 2020 (N=2496); 2021 (N=2500); 2022 (N=2500).

Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

PËRVOJA PERSONALE ME KORRUPSIONIN


Në vitin 2022, 15.4% e shqiptarëve deklaruan se ishin dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel të qeverisjes qendrore dhe 22% në nivel vendor të qeverisjes.

Nga sondazhi u konstatua se gjatë vitit 2022, 15.4% e të anketuarve raportuan se ishin dëshmitarë të korrupsionit në qeverinë qendrore. Nga ana tjetër, më pak se dy në dhjetë (18.5%) e të anketuarve thanë se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel vendor të qeverisjes.

Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin (2022)

At Central Level Government

At Local Level Government



Baza: Qeveria qendrore (N=2491); Qeveria vendore (N= 2487)

Gratë (14%) dhe burrat (17%) ishin pothuajse të ngjashëm në përqindje të raportonin se kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit të qeverisë qendrore. Nga kategoritë e tjera demografike, ata të moshës 26-35 vjeç dhe ata me një diplomë universitare (ose pasuniversitare) ishin më të prirur të raportonin se ishin dëshmitarë të rasteve të korrupsionit të qeverisë qendrore.


Nuk kishte dallime të mëdha në përqindje mes grave (20%) dhe burrave (24%) që raportonin se kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel vendor. Të anketuarit që punojnë në sektorin publik dhe ata me të ardhura mujore deri në 30,000 lekë kishin më pak gjasa se grupet e tjera demografike të raportonin se kishin parë personalisht raste korrupsioni në nivel vendor.

Gjatë vitit 2022, një pjesë më e madhe e të anketuarve raportuan ishin dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel qendror, një rritje prej 4 pp në vitin 2021 (11%), por e ngjashme me atë të vitit 2020 (15%). Në nivel vendor, përqindja e 2022 të anketuarve që kanë paguar ryshfet është rritur lehtë (22%) krahasuar me vitin 2021 (18%), por ka mbetur 1 pp nën shifrën e vitit 2020 (23%).

PËRVOJA PERSONALE ME KORRUPSIONIN, GJETJET NË VITE

Gjetjet tregojnë se gjatë viteve 2016-2022 mesatarisht 14% (maksimumi 15%, minimumi 10%) e të anketuarve raportuan se ishin dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror dhe 21% (maksimum 25%, minimumi 15%) në nivel vendor.

Figura 24: Përvoja personale me korrupsionin (2016-2022)



Baza: Për qeverinë qendrore: 2016 (N=1633); 2017 (N=1638); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483); 2021 (N=2489); 2022 (N=2491). Për qeverinë vendore: 2016 (N=1633); 2017 (N=1639); 2018 (N=1631); 2019 (N=2487); 2020 (N=2483); 2021 (N=2490); 2022 (N=2487).


Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

PËRHAPJA E RYSHFETIT

Në vitin 2022, një e treta (30.9%) e qytetarëve që kanë marrë shërbim nga institucione të qeverisë qendrore (N=996) raportuan se kishin paguar ryshfet zyrtarëve publikë. Nga ana tjetër, 32.7% e qytetarëve që kishin marrë shërbime nga institucione të qeverisë vendore në 2022 (N=1460) raportuan se kishin paguar ryshfet zyrtarëve të këtij niveli qeverisjeje.


Gjatë vitit 2022, katër në dhjetë të anketuar (40.1%, N=996) thanë se kishin marrë shërbim nga institucionet publike në nivel qendror, ndërsa 59.9% (N=1486) nuk kishin marrë shërbime të tilla. Nga ata që kishin marrë një shërbim të qeverisë qendrore, 30.9% (307 nga 996) raportuan se i kishin paguar ryshfet një nëpunësi publik.

Figura 25: Shërbimet e marra në nivel qendror (2022)




Baza: N = 2482

Figura 26: Ryshfet i paguar në nivel qendror (2022)




Baza: N = 996

Për shërbimet e marra në nivel vendor, 58.8% (N=1460) e të anketuarve kanë raportuar se kanë përdorur shërbime e qeverisjes vendore, ndërsa 41.2% (N=1022) thanë 'jo'. Nga ata që kishin marrë një shërbim në nivel vendor, 32.7% (476 nga 1460) raportuan se i kishin paguar ryshfet një nëpunësi publik.

Figura 27: Shërbimet e marra në nivel vendor (2022)

Baza: N = 2482

Figura 28: Ryshfet i paguar në nivel vendor (2022)

Baza: N = 1460

Mes grave (21%) dhe burrave (28%) pati dallime të vogla për pagesën e ryshfetit për një shërbim të qeverisë qendrore. Të anketuarit që punojnë në sektorin publik dhe ata të moshës 56-65 vjeç kishin më pak gjasa të deklaroheshin se kishin paguar ryshfet për një shërbim të qeverisë qendrore. Po kështu, në nivel vendor, gratë (28%) dhe burrat (33%) prirën t'i paguajnë ato në përqindje pothuajse të njëjtë. Pjesëmarrësit e anketuar që punojnë në sektorin publik dhe ata të grupmoshës 56-65 vjeç kishin më shumë gjasa të angazhoheshin në ryshfet në nivel vendor.

Në vitin 2022, një përqindje më e vogël e të anketuarve (31%) kanë raportuar se kanë paguar ryshfet në institucionet e nivelit qendror sesa në vitin 2021 (35%) dhe pak më e vogël se në vitin 2020 (32%). Nga ana tjetër, përqindja që raportuan se kishin paguar ryshfet në institucionet e nivelit vendor ishte pak më e lartë në vitin 2022 (33%) krahasuar me vitin 2021 (29%), ndërsa relativisht e ngjashme me atë të vitit 2020 (32%).

Tabela 11: Arsyet e pagimit të ryshfetit (2022)

	N	%
Ma kërkuan ryshfetin	293	50.3
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	82	14.1
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	142	24.4
Tjetër*	65	11.2
Gjithsej	582	100.0


*Tjetër: "Nuk të shërbejnë nëse nuk u jep ryshfet"; "për të marrë shërbim më të shpejtë".

Të pyetur për arsyet pse kanë dhënë ryshfet, gjysma e të anketuarve (50.3%) thanë se u ishte kërkuar. Arsyeja tjetër më shpesh e përmendur (24.4%) ishte për të marrë shërbime më të mira herën tjetër, ndërsa 14.1% e bënë këtë si mirënjohje për shërbimet e marra.

Mes qytetarëve që raportuan se kishin paguar ryshfet, vetëm 11.2% (N=64) thanë se e kishin raportuar atë tek autoritetet, duke evidentuar kështu se 88.8% (N=508) nuk e kishin raportuar rastin. Sa i përket arsyeve të mosraportimit të ryshfetit, 37.4% thanë se besojnë se kjo është një praktikë e zakonshme, 32.1% treguan se raportimi nuk ia vrente pasi askush nuk do të merrej me të, dhe 12.3% thanë se nuk e kishin raportuar nga pasojat e raportimit.

PËRHAPJA E RYSHFETIT, GJETJET NË VITE

Pavarësisht disa luhatjeve gjatë viteve 2016-2022, ryshfeti i raportuar si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor, i ndikuar pjesërisht nga numri i ndryshëm i të anketuarve që kanë marrë shërbime publike, ka mbetur në një nivel të ngjashëm dhe mesatarisht në 30% dhe 32%, për nivelet përkatëse të qeverisjes.

Figura 29: Përhapja e ryshfetit (2016-2022)

Baza: Në nivel vendor: 2016 (N=838); 2017 (N=916); 2018 (N=924); 2019 (N=1744); 2020 (N=1575); 2021 (N=1672); 2022 (N=1460). Në nivel qendror: 2016 (N=406); 2017 (N=561); 2018 (N=648); 2019 (N=1518); 2020 (N=1046); 2021 (N=973); 2022 (N=996).

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

4.4 NDIKIMI I INTERESAVE POLITIKE

Vlerësimi i ndikimit politik në proceset e vendimmarrjes është kritik për shkak të potencialit për të shtyrë interesa specifike, duke minuar kështu pavarësinë e institucioneve publike dhe funksionimin e shoqërisë demokratike dhe duke dëmtuar besimin e qytetarëve tek qeveria. Si pjesë e këtij sondazhi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej pesë pikësh nga 1 (nuk ndikon aspak) në 5 (ndikon jashtëzakonisht shumë) – sipas mendimit të tyre, sa ndikojnë interesat politike në axhendën e nëntë institucioneve – prokuroria, gjykatat, policia, forcat e armatosura, institucionet e shëndetit publik, institucionet arsimore, media, institucionet fetare, organizatat e shoqërisë civile dhe SPAK (shtuar në sondazhin e 2022).

INTERESAT POLITIKE NË AXHENDËN E INSTITUCIONEVE NË VITIN 2022


Gjykatat u konsideruan si institucionet më të ndikuara politikisht, ndërsa institucionet fetare u perceptuan si institucionet më pak të ndikuara politikisht. Struktura e Posaçme Kundër Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) u shtua në institucionet e listuara në vitin 2022. 31.8% e shqiptarëve e shohin SPAK-un si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuar nga interesat politike, ndërsa 37.9% e perceptuan si pak ose aspak të ndikuar.

Të dhënat nxorën në pah dallime të mëdha në perceptimin e ndikimit të interesave politike në institucione të ndryshme. 66.4% e të anketuarve raportuan se institucionet fetare ose nuk ishin aspak të ndikuar ose pak të ndikuar nga interesat politike. Pas institucioneve fetare vinin organizatat e shoqërisë civile që shihen nga të anketuarit si më pak të ndikuara nga interesat politike, me 48.3% që i konsideronin ato si të ndikuara ose pak të ndikuara. Po ashtu, forcat e armatosura u vlerësuan si të pandikuara ose pak të ndikuara nga 47.3% e të anketuarve, të ndjekura nga institucionet e arsimit publik (41%) dhe institucionet e shëndetit publik (39.2%). Edhe pse perceptimi i ndikimit politik në gjykata u përmirësua me 6.5 pikë përqindje nga viti 2021, 41.8% e të anketuarve në sondazhin e këtij viti ende i konsiderojnë ato si të ndikuar shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike. Vetëm 28.6% e të anketuarve i shihnin gjykatat si aspak ose pak të ndikuar nga interesat politike.

Krahasuar me vitin 2021, prokuroria pati një përmirësim prej 9.7 pikë përqindjeje, me 38.6% të të anketuarve që vlerësuan se interesat politike “ndikojnë shumë” ose “jashtëzakonisht shumë”. 28.5% e të anketuarve ishin neutrale për këtë çështje, ndërsa 30.6% besonin se prokuroria “nuk është aspak” ose “pak e ndikuar” nga politika.

Rezultatet për institucionin e shtuar në sondazhin e vitit 2022 tregojnë se 37.9% e të anketuarve mendonin se SPAK nuk ishte aspak i ndikuar ose pak i ndikuar nga interesat politike, ndërsa 27% e të anketuarve nuk kishin mendim për këtë çështje. Nga ana tjetër, 31.8% e të anketuarve besonin se interesat politike ndikonin shumë ose jashtëzakonisht shumë tek SPAK.

Vlen të përmendet se edhe përgjigja neutrale u përzgjedh relativisht shpesh për të gjitha institucionet e listuara në këtë sondazh.

Figura 30: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në agjendën e institucioneve (2022)

Baza: N=2500 për të gjitha institucionet.

KRAHASIMI DEMOGRAFIK I PERCEPTIMIT TË NDIKIMIT POLITIK

Të anketuarit gra dhe burra kishin perceptime të ngjashme për nivelin e ndikimit politik tek institucionet e listuara. Kur analizojmë të gjitha grupmoshat e të anketuarve, të anketuarit më të vjetër në moshë prireshin t'i perceptonin institucionet e listuara si më të ndikuara politikisht. Për shembull, të anketuarit e moshës 56-65 vjeç i shihnin gjykatat (48%) si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika, që përbën perceptimin më i lartë të ndikimit politik nga të gjitha grupmoshat.

Për sa i përket nivelit arsimor, të anketuarit me diplomë universitare kishin perceptime të ngjashme për ndikimin politik tek institucionet në krahasim me të anketuarit e tjerë me nivel më të ulët arsimor. Të punësuarit në sektorin publik ishin më të prirur për të t'i konsideruar institucionet e listuara pak ose aspak të ndikuara nga politika. Të punësuarit në sektorin privat prireshin t'i konsideronin gjykatat (46%) dhe prokurorinë (43%) si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga interesat politike.

Sipas nivelit të të ardhurave, të anketuarit me të ardhura më të larta prireshin t'i konsideronin institucionet si më të ndikuara politikisht sesa ata me të ardhura më të pakta. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që fitonin mbi 70,001 lekë në muaj i konsideronin gjykatat (54%) si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuar nga interesat politike.

Së fundmi, të anketuarit nga zonat rurale kishin më shumë gjasa të shpreheshin se të gjitha institucionet e listuara ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë në krahasim me ata nga zonat urbane. Për të gjitha gjetjet sipas ndarjeve demografike, shih Tabelën 13 në fund të këtij kreu.

NDIKIMI POLITIK NË VITE

Tabela e mëposhtme tregon përqindjet e përgjigjeve “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht të ndikuara” për të nëntë institucionet e listuara në vitet 2016-2022.

Gjatë kësaj periudhe, shumë nga institucionet e listuara u perceptuan të ndikuara nga interesat politike, ku gjykatat dhe prokuroria konsideroheshin vazhdimisht si më të ndikuarat. Gjithsesi, ka pasur disa ndryshime të dukshme me kalimin e viteve dhe mes institucioneve.

Për shembull, përqindja e të anketuarve që i konsideronin gjykatat si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika u ul ndjeshëm nga 70% në 2016 në 42% në 2022. Po ashtu, përqindja e të anketuarve që e konsideronin prokurorinë si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuar u ul nga 67% në 2016 në 39% në 2022.

Në vite, sistemi i kujdesit shëndetësor, sistemi arsimor dhe media kanë parë nivele relativisht të qëndrueshme të perceptimit të ndikimit politik, me rreth 30-40% të të anketuarve që i vlerësojnë ato si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara. Edhe policia është vlerësuar vazhdimisht e lartë, me rreth 40-50% të të anketuarve që e perceptojnë atë si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuar nga politika.

OSHC-të, forcat e armatosura dhe institucionet fetare përgjithësisht perceptohen se ndikohen fare pak nga politika në krahasim me institucionet e tjera, me një mesatare prej 20-30% të të anketuarve që i vlerësojnë ato si shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara politikisht.

Tabela 12: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016-2022)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	Mesatare
Prokuroria		70%	63%	61%	56%	49%	42%	57%
Gjykatat		67%	60%	59%	58%	48%	39%	55%
Policia	46%	47%	48%	44%	45%	39%	38%	43%
Media	45%	37%	39%	45%	42%	38%	36%	40%
Institucionet e shëndetit publik	41%	34%	36%	33%	37%	32%	30%	34%
Institucionet e arsimit publik	38%	29%	34%	33%	34%	30%	28%	31%
Forcat e armatosura	33%	29%	33%	30%	29%	26%	26%	29%
OSHC-të	20%	26%	24%	23%	19%	20%	19%	22%
Institucionet fetare	9%	9%	12%	10%	12%	11%	12%	11%

Baza: Në rendin sipas listës: 2016 (N= 1633, 1621, 1621, 1626, 1629, 1628, 1630, 1628); 2017 (N= 1615, 1616, 1611, 1608, 1615, 1613, 1612, 1614, 1615); 2018 (N= 1628, 1631, 1624, 1614, 1626, 1633, 1629, 1628, 1632); 2019 (N=2488); 2020 (N= 2490); 2021 (N=2495, 2495, 2492, 2475, 2490, 2490, 2493, 2492, 2495) 2022 (N=2500 për të gjitha institucionet e listuara).

* Që nga viti 2017 e më tej, ‘Gjyqësori’ është ndarë në ‘Prokurori’ dhe ‘Gjykata’.

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Legjenda: Ngjyrat nga e kuqja e errët në të kuqe të çelët dhe më pas nga e gjelbra e çelët në të gjelbër të errët shfaqin luhatje duke iu referuar shenjës 50% nga vlerat më të ulëta në ato më të larta.

Tabela 13: Ndarja demografike e institucioneve 'shumë të ndikuara' ose 'jashtëzakonisht shumë të ndikuara' nga politika (2022)

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Institucionet e shëndetit publik	Institucionet e shëndetit publik	Mediat	Institucionet fetare	OSHC-të	SPAK	
Gjithsej (% e 'shumë' ose 'jashtëzakonisht shumë' të ndikuara)	39%	42%	38%	26%	30%	28%	36%	12%	19%	32%	
Gjinia											
Burra	40%	43%	39%	27%	31%	29%	37%	14%	18%	34%	
Gra	37%	40%	37%	25%	28%	27%	35%	11%	21%	29%	
Mosha											
18-25 vjeç	36%	39%	37%	24%	30%	30%	33%	11%	17%	31%	
26-35 vjeç	39%	41%	37%	26%	28%	27%	38%	12%	21%	33%	
36-45 vjeç	37%	41%	38%	27%	30%	29%	38%	15%	22%	32%	
46-55 vjeç	42%	44%	39%	28%	31%	30%	34%	12%	19%	34%	
56-65 vjeç	43%	48%	42%	28%	33%	28%	39%	15%	19%	33%	
Mbi 66 vjeç	33%	37%	30%	21%	24%	23%	31%	7%	11%	24%	
Niveli arsimor											
Me arsim deri 8/9-vjeçar*	35%	39%	36%	28%	29%	26%	33%	14%	17%	30%	
Me arsim të mesëm	42%	44%	38%	27%	30%	29%	37%	12%	20%	32%	
Me arsim universitar	38%	41%	38%	24%	29%	28%	36%	12%	20%	32%	
Statusi i punësimit											
I/E punësuar	Gjithsej	39%	42%	37%	25%	27%	26%	37%	12%	20%	32%
	Spektori publik	27%	31%	28%	18%	20%	19%	29%	8%	15%	22%
	Spektori privat	43%	46%	41%	27%	30%	29%	41%	13%	22%	36%
I/E papunë	36%	42%	42%	31%	34%	29%	34%	16%	21%	32%	
Student	37%	41%	37%	25%	35%	36%	32%	9%	18%	31%	
Pensionist	35%	40%	33%	23%	27%	26%	35%	11%	14%	28%	
Niveli i të ardhurave											
Pa të ardhura	36%	42%	39%	28%	34%	31%	33%	13%	19%	31%	
Deri në 30,000 lekë	41%	42%	38%	26%	30%	28%	34%	11%	16%	30%	
30,001-50,000 lekë	37%	38%	34%	23%	25%	24%	36%	11%	20%	30%	
50,001-70,000 lekë	33%	37%	32%	22%	26%	25%	35%	12%	19%	29%	
Mbi 70,001 ALL	46%	54%	52%	32%	33%	35%	48%	17%	28%	45%	
Vendbanimi											
Urban	36%	40%	35%	23%	28%	26%	33%	11%	18%	30%	
Rural	44%	45%	42%	31%	32%	31%	48%	15%	22%	36%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.5 PJESËMARRJA QYTETARE


Pjesëmarrja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes pasqyron cilësinë e qeverisjes dhe gjendjen e demokracisë në një vend. Ashtu si edhe në vitet e kaluara, pyetjet e sondazhit të vitit 2022 matin interesin dhe mundësitë e të anketuarve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes, pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike dhe arsyet për mospjesëmarrjen në vendimmarrje. Pyetjet e tjera kishin të bënin me përfshirjen në punë vullnetare, pjesëmarrjen në demonstrata/tubime dhe nënshkrimin e peticioneve. Të anketuarit u pyetën edhe për portalin e konsultimeve 'konsultimipublik.gov.al' dhe nëse e kishin përdorur këtë portal për të dhënë mendimin e tyre për projektligje apo projektstrategji/plane veprimi. Ata u pyetën edhe nëse kanë ndërmend të largohen nga vendbanimi i tyre, brenda apo jashtë Shqipërisë.

PJESËMARRJA NË VENDIMMARRJE

Përqindja e shqiptarëve të interesuar për të marrë pjesë në vendimmarrje në vitin 2022 nuk ka ndryshuar shumë nga viti 2021 (45.3% kundrejt 43.5%). Shumica e qytetarëve mendojnë se nuk ka mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë në rastin e institucioneve publike të nivelit qendror.

Në vitin 2022, 45.3% e të anketuarve thanë se ishin të interesuar për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike, një përqindje pak më e lartë se në vitin 2021 (45.3% me 43.5%).

Figura 31: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike (2022)




Baza: N = 2497

Një përqindje e ngjashme e grave dhe burrave, përkatësisht 45% dhe 45.7%, ishin të interesuar për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Të anketuarit me diplomë universitare (ose pasuniversitare), studentët, të punësuarit në sektorin publik dhe anëtarët e partive politike ishin më të prirur të shpreheshin se ishin të interesuar të merrnin pjesë në procesin e vendimmarrjes në krahasim me grupet e tjera. Shih Tabelën 15 në fund të këtij kreu për më shumë informacione.

72.6% e të anketuarve mendojnë se mundësitë për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të qeverisë

qendrore nuk janë të mjaftueshme, krahasuar me 72.2% në vitin 2021. Ndërkohë, 62.2% e të anketuarve mendojnë se mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore nuk janë të mjaftueshme -krahasuar me 61.9% në 2021.

Figura 32: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2022)



Baza: Për qeverinë qendrore: N=2490; Për qeverinë vendore: N=2490.

Pothuajse e njëjta përqindje mes grave (27.2%) dhe e burrave (27.6%) mendonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e qeverisë qendrore. Në nivel vendor, 36.5% e grave dhe 39.3% e burrave u shprehën se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë – një diferencë prej 2.8 pikë përqindjeje.


MUNDËSITË PËR PJESËMARRJE NË VENDIMMARRJE NË VITE

Në Figurën 33 jepen ndryshimet në vite për sa i përket përqindjes së të anketuarve që deklarorin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Në periudhën 2016-2022, përqindja e qytetarëve që raportuan se nuk kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore është nën 40%. Që nga viti 2019, ka një stanjacion të tendencave në lidhje me perceptimin e mundësive për pjesëmarrje në vendimmarrje në të dy nivelet e qeverisjes.

Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore u vlerësuan më lart, me një mesatare prej 37%, krahasuar me nivelin qendror, i cili kishte një mesatare prej 27% gjatë viteve 2016-2022.

Figura 33: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2016–2022)



Baza: Për qeverinë qendrore: 2016 (N=1633); 2017 (N=1634); 2018 (N=1630); 2019 (N=2480); 2020 (N = 2482); 2021 (N = 2490); 2022 (N = 2490). Për qeverinë vendore: 2016 (N=1634); 2017 (N=1630); 2018 (N=1638); 2019 (N=2463); 2020 (N = 2491); 2021 (N = 2494); 2022 (N = 2490).


***Shënim:** Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

PROCESET E KONSULTIMIT

Në vitin 2022, 11.8% e shqiptarëve të anketuar thanë se ishin ftuar për të marrë pjesë në procese konsultimi të organizuara nga institucionet publike në nivel qendror; ndërkohë, një përqindje më e lartë, 18.6%, raportuan se ishin ftuar në procese konsultimi të organizuara në nivel vendor. Arsyeja kryesore e përmendur për mungesën e pjesëmarrjes ishte mungesa e besimit te vetë proceset e konsultimit.

11.8% e të anketuarve raportuan se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel të qeverisjes qendrore, përqindje që është në rritje nga 9.7% në vitin 2021. Një përqindje më e lartë, 18.6%, raportuan se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të nivelit vendor, një tjetër rritje në krahasim me vitin 2021 (17.8%).

Figura 34: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2022)




Base: For central government N=2483; for local government N=2492.

PJESËMARRJA NË KONSULTIME NË VITE

Në Figurën 35 jepen ndryshimet në vite në të dy nivelet e qeverisjes në lidhje me ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit. Gjetjet në vite tregojnë se pjesëmarrja aktuale në proceset vendimmarrëse ishte më e ulët, nën 25%, sesa perceptimi për mundësitë e një pjesëmarrjeje të tillë.

Disa nga arsyet kryesore pse të anketuarit nuk kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit gjatë viteve 2016-2022 ishin mungesa e besimit se pjesëmarrja e tyre do të kishte ndikim, pritshmëria se duhet të marrin pjesë të tjerë dhe besimi se nuk ka mekanizma apo procese konsultimi.

Figura 35: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016-2022)




Baza: Në qeverisjen vendore: 2016 (N=1624); 2017 (N=1635); 2018 (N=1629); 2019 (N=2482); 2020 (N=2486); 2021 (N=2494); 2022 (N=2492). Në qeverisjen qendrore: 2016 (N=1631); 2017 (N=1635); 2018 (N=1630); 2019 (N=2483); 2020 (N=2486); 2021 (N=2494); 2022 (N=2493).

***Shënim:** Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Në vitin 2022, 9.9% e të anketuarve raportuan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga qeveria qendrore, krahasuar me 7.4% në vitin 2021. Ndërkohë, 16.7% raportuan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga qeverisja vendore, krahasuar me 14.5% në 2021.

Figura 36: Pjesëmarrja në takime konsultimi (2022)



Baza: Për qeverisjen qendrore: N = 2353; Për qeverisjen vendore: N = 2377.


Arsyeja kryesore e dhënë për mungesën e pjesëmarrjes ishte mungesa e besimit te konsultimet (37.3%), e ndjekur nga besimi se nuk ka mekanizma konsultimi në fuqi (21.3%) dhe pritshmëria se do të merrnin pjesë të tjerët (16.5%). Arsyet e tjera ishin besimi se proceset e konsultimit “janë të hapura vetëm për anëtarët e partisë” ose “janë vetëm takime formale, pa rezultate”.

Tabela 14: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet konsultuese në vitin 2022

	N	%
Pres ta bëjnë të tjerët	524	25.7%
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	551	27.1%
Nuk kam pasur informacion mbi temën	207	10.2%
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit ose te qasja online takimin konsultues	185	9.1%
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	366	18%
Tjetër*	202	9.9%

*Përgjigje të shpeshta në kategorinë “tjetër” ishin “[proceset e konsultimit] janë të hapura vetëm për anëtarët e partisë”, “[proceset e konsultimit] janë vetëm takime formale, pa rezultate”, mungesa e arsimit, probleme shëndetësore dhe mosha e vjetër.

18.1% e pjesëmarrësve në sondazh raportuan se kanë përdorur portalin www.konsultimipublik.gov.al për të marrë informacion ose për të dhënë mendimin e tyre për projektligjet ose projektstrategjitë/planet e veprimit – përqindje pak më e lartë se në vitin 2021 (18.1% me 16,6%).

Figura 37: Përdorimi i portalit “Konsultimipublik.gov.al” në vitin 2022

Baza: N=2482


Nga 449 të anketuar që kishin përdorur portalin online, 52.8% ishin gra dhe 47.2% ishin burra. Shih Tabelën 16 për më shumë informacione për dallimet sipas grupeve demografike.

POHIMET PËR ANGAZHIMIN QYTETAR

Në vitin 2022, pjesa më e madhe e shqiptarëve të anketuar (73%) besonin se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse vendimet e qeverisë janë të mira apo të këqija. Ndërkohë, 39.2% janë dakord që sugjerimet e organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit merren parasysh, 37.6% janë dakord që këshillat bashkiakë përfaqësojnë komunitetet vendore dhe 36.6% janë dakord se buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve. Një përqindje e konsiderueshme, 60.9%, mendojnë se dëgjesat publike vendore kanë pak ndikim në vendimet e bashkisë.

Plot 73% e pjesëmarrësve në këtë sondazh (73.3% e grave dhe 72.7% e burrave) thanë se janë dakord ose plotësisht dakord se “Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq”. 39.2% e të anketuarve (39.9% e grave dhe 38.6% e burrave) thanë se janë dakord ose plotësisht dakord që “sugjerimet që vijnë nga shoqërisë civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë”. Plot 60.9% e të anketuarve (61.1% e grave dhe 60.8% e burrave) thanë se janë dakord ose plotësisht dakord se “dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake”. 37.6% e të anketuarve u shprehën se janë dakord ose plotësisht dakord që “këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake”. Një përqindje më e lartë e grave se e burrave ishin dakord me këtë pohim, edhe pse pa shumë dallim (39.2% me 36.0%). 36.6% u shprehën se janë dakord ose plotësisht dakord se “buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve”. Një përqindje më e lartë e grave se e burrave ishin dakord me këtë pohim, por përsëri pa diferencë të madhe (36.0% me 33.8%). Punonjësit e sektorit publik prireshin më shumë se punonjësit e sektorit privat për të qenë dakord me këto pohime. Në Tabelën 17 ofrohen më shumë informacione për dallimet ndërmjet karakteristikave demografike.

Figura 38: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar (2022)




Baza: N1 = 2463, N2 = 2428, N3 = 2423, N4 = 2423, N5 = 2386.

PJESËMARRJA NË NJË DEMONSTRATË/TUBIM APO NËNSHKRIMI I NJË PETICIONI

Përqindje e shqiptarëve të anketuar që kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo që kishin nënshkruar një peticion u rrit nga 27.1% në vitin 2021 në 32.2% në 2022.

32.2% e pjesëmarrësve në këtë studim raportuan se kishin marrë pjesë në një demonstratë apo tubim apo se kishin nënshkruar një peticion në vitin 2022, përqindje që është rritur për të tretin vit radhazi që nga 2021 (27.1%) dhe 2020 (22%).

Figura 39: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2022



Baza: N = 2490

Arsyeja kryesore pse kishin marrë pjesë në një demonstratë/ tubim ose nënshkruar një peticion në 2022 ishte “interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj” (50.4%), ndjekur nga “interesi personal” (31.6%), “militantizmi (për mbështetje politike)” (13,3%), dhe “presioni i shokëve/të njohurve” (3.1%). Mungesa e kohës u citua nga të anketuarit si pengesa kryesore për pjesëmarrjen.


Një përqindje më e lartë e burrave se e grave (34.6% me 30.0%) kanë raportuar se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion në vitin 2022. Të anketuarit me diplomë universitare (apo pasuniversitare), studentët, të punësuarit në sektorin publik, banorët e zonave urbane, dhe anëtarët e partive politike ishin më të prirur të raportonin se kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim ose se kishin nënshkruar një peticion në vitin 2022.

PJESËMARRJA NË NJË DEMONSTRATË/TUBIM APO NËNSHKRIMI I NJË PETICIONI NË VITE

Siç paraqitet edhe në Figurën 40, në vitet e fundit ka pasur një tendencë në rritje të pjesëmarrjes në demonstrata/tubime apo nënshkrime peticionesh. Përqindja e shqiptarëve që kishin marrë pjesë në tubime/demonstrata apo që kishin nënshkruar peticione u rrit ndjeshëm pas vitit 2020. Në vitin 2022, shifrat ishin 10 pikë përqindjeje më të larta se në vitin 2016, 32% kundrejt 22%.

Arsyet kryesore që të anketuarit dhanë për pjesëmarrje ishin interesi i përbashkët i komunitetit ku banonin dhe interesi personal.

Figura 40: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni (2016-2022)



Baza: 2022 (N=2490); 2021 (N=2500); 2020 (N=2483); 2019 (N=2479); 2018 (N=1636); 2017 (N=1637); 2016 (N=1597)


*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

GATISHMËRIA PËR T’U ANGAZHUAR NË PUNË VULLNETARE

61.5% e të anketuarve në Shqipëri ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare në vitin 2022.

61.5% e të anketuarve raportuan se ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare për të mirën e komunitetit ku jetonin, përqindje që ka rënë krahasuar me 65.1% të vitit 2021.

Figura 41: Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare (2022)



Baza: N=2484


Përqindja e grave që shprehën gatishmërinë për t'u angazhuar në punë vullnetare është më e madhe se e burrave. Dallimi, gjithsesi, është i vogël (62.1% unë 60.9%). Të anketuarit më të rinj se 45 vjeç, ata me diplomë universitare (ose pasuniversitare), të punësuarit në sektorin publik dhe studentët prireshin më shumë për të shprehur gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në punë vullnetare në krahasim me grupet e tjera demografike.

LARGIMI NGA VENDBANIMI AKTUAL

Në vitin 2022, 38.3% e popullsisë shqiptare dëshironte të largohej nga vendi për të emigruar, përqindje pak më e ulët se në vitin 2021. Arsyet kryesore të dëshirës për të shkuar në një shtet tjetër ishin për një jetë më të mirë, gjetja e një pune dhe mundësive profesionale dhe përballimi i vështirësive ekonomike.

38.3% e të anketuarve (38% gra dhe 38.5% burra) raportuan se donin të largoheshin drejt një vendi tjetër në vitin 2022, përqindje që ka rënë me 2.7 pikë përqindjeje që nga viti 2021 (41%).; ndërkohë, 5.3% e pjesëmarrësve në këtë sondazh (5.2% gra dhe 5.5% burra) thanë se donin të shpërnguleshin në zona të tjera brenda vendit. 56.4% e të anketuarve thanë se nuk kishin në plan të ndërronin vendbanimin e tyre në 2022.

Figura 42: Largimi nga vendbanimi aktual (2022)



Baza: N=2488


Të anketuarit që u shprehën se duan të largohen nga vendbanimi i tyre i tanishëm drejt një shteti tjetër renditën si arsyt kryesore “dëshirën për një jetë më të mirë” (11.2%), “mundësitë e punësimit dhe zhvillimit profesional” (10.1%) dhe “arsye ekonomike” (8.7%). Arsyet e tjera kishin të bënin me jetesën në vende më të sigurta, bashkimin me anëtarët e familjes që jetojnë jashtë vendit, marrjen e shërbimeve më cilësore arsimore dhe shëndetësore. Korrupsioni dhe mungesa e drejtësisë në Shqipëri ishin ndër arsytet e tjera që dhanë të anketuarit për largimin nga vendi. Të anketuarit nga 18 deri në 25 vjeç, ata me diplomë universitare (ose pasuniversitare), punonjësit e sektorit privat dhe studentët ishin më shumë të prirur për të emigruar.

LARGIMI NGA VENDBANIMI AKTUAL NË VITE

Siç tregohet në Figurën 43, 46% e shqiptarëve shprehën dëshirën për t'u larguar drejt një shteti tjetër në vitin 2019, përqindje që ka rënë gradualisht çdo vit, duke kulmuar me një rënie prej 8 pikë përqindjeje në vitin 2022. Ndërkohë, përqindja e shqiptarëve që dëshironin të shpërnguleshin drejt një zone tjetër brenda vendit ka mbetur në një nivel të ngjashëm që nga viti 2019.

Ndër arsytet kryesore të përmendura gjatë kësaj periudhe për largimin drejt një shteti tjetër ishin mundësitë për një jetë më të mirë, faktorët ekonomikë dhe zhvillimi profesional.

Figura 43: Largimi nga vendbanimi aktual (2019-2022)



Baza: 2022 (N=2488); 2021 (N=2495); 2020 (N=2481); 2019 (N=2489).

***Shënim:** Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 15: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2022)

		Qeveria qendrore		Qeveria vendore	
		Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes		Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje	
Gjithsej		45%	27%	38%	
Gjinia					
Gra		45%	27%	36%	
Burra		46%	28%	39%	
Mosha					
18-25 vjeç		55%	34%	45%	
26-35 vjeç		57%	36%	45%	
36-45 vjeç		47%	29%	42%	
46-55 vjeç		40%	22%	32%	
56-65 vjeç		35%	19%	31%	
Mbi 66 vjeç		23%	15%	22%	
Niveli arsimor					
Me arsim deri 8/9-vjeçar		28%	14%	22%	
Me arsim të mesëm		40%	21%	33%	
Me arsim universitar		62%	43%	53%	
Statusi i punësimit					
I/E punësuar	Gjithsej	51%	31%	43%	
	Spektori publik	64%	44%	55%	
	Spektori privat	46%	26%	37%	
I/E papunë		41%	22%	31%	
Student		62%	38%	50%	
Pensionist		19%	13%	20%	
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura		45%	24%	33%	
Deri në 30,000 lekë		33%	18%	27%	
30,001-50,000 lekë		47%	28%	40%	
50,001-70,000 lekë		58%	40%	52%	
Mbi 70,001 ALL		57%	32%	42%	
Vendbanimi					
Urban		46%	27%	38%	
Rural		44%	27%	37%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 16: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2022—Vetëm përgjigjet e kategorisë “Po”

	Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2022		Pjesëmarrja faktike në konsultime në 2022		Përdorimi i platformës konsultimipublik.gov.al	
	Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor		
Gjithsej	12%	19%	10%	17%	18%	
Gjinia						
Gra	12%	19%	10%	17%	19%	
Burra	11%	18%	10%	17%	17%	
Mosha						
18-25 vjeç	10%	16%	11%	19%	26%	
26-35 vjeç	16%	24%	14%	22%	23%	
36-45 vjeç	15%	22%	12%	18%	21%	
46-55 vjeç	10%	16%	8%	14%	15%	
56-65 vjeç	7%	15%	5%	11%	9%	
Mbi 66 vjeç	6%	12%	5%	11%	6%	
Niveli arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar	8%	12%	6%	11%	8%	
Me arsim të mesëm	8%	15%	7%	13%	15%	
Me arsim universitar	18%	26%	16%	24%	27%	
Statusi i punësimit						
I/E punësuar	Gjithsej	13%	22%	12%	19%	21%
	Sektori publik	23%	36%	23%	32%	33%
	Sektori privat	10%	16%	7%	15%	16%
I/E papunë	10%	15%	7%	14%	13%	
Student	12%	17%	11%	19%	29%	
Pensionist	5%	10%	5%	9%	6%	
Niveli i të ardhurave						
Pa të ardhura	11%	15%	8%	14%	15%	
Deri në 30,000 lekë	7%	12%	6%	11%	11%	
30,001-50,000 lekë	13%	22%	11%	20%	22%	
50,001-70,000 lekë	18%	28%	16%	26%	26%	
Mbi 70,001 ALL	16%	20%	9%	16%	27%	
Vendbanimi						
Urban	12%	20%	10%	17%	19%	
Rural	11%	17%	10%	16%	16%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 17: Ndarja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në (2022)-Përgjigjet “Jam dakord” dhe “Jam plotësisht dakord”

	Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve	
Gjithsej	73%	39%	61%	38%	35%	
Gjinia						
Gra	73%	40%	61%	39%	36%	
Burra	73%	39%	61%	36%	34%	
Mosha						
18-25 vjeç	74%	38%	62%	33%	33%	
26-35 vjeç	73%	37%	65%	39%	35%	
36-45 vjeç	72%	40%	59%	41%	38%	
46-55 vjeç	73%	37%	61%	35%	35%	
56-65 vjeç	68%	38%	58%	33%	29%	
Mbi 66 vjeç	81%	50%	56%	45%	38%	
Niveli arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar	70%	34%	55%	34%	33%	
Me arsim të mesëm	74%	39%	62%	37%	35%	
Me arsim universitar	74%	42%	63%	41%	37%	
Statusi i punësimit						
I/E punësuar	Gjithsej	74%	40%	62%	40%	37%
	Sektori publik	81%	59%	59%	61%	54%
	Sektori privat	71%	33%	63%	32%	30%
I/E papunë	69%	33%	60%	31%	30%	
Student	72%	36%	67%	32%	33%	
Pensionist	76%	48%	54%	41%	37%	
Niveli i të ardhurave						
Pa të ardhura	71%	33%	62%	29%	29%	
Deri në 30,000 lekë	72%	41%	59%	38%	35%	
30,001-50,000 lekë	75%	41%	61%	40%	36%	
50,001-70,000 lekë	77%	45%	60%	48%	47%	
Mbi 70,001 ALL	66%	37%	70%	29%	27%	
Vendbanimi						
Urban	73%	39%	59%	37%	35%	
Rural	73%	39%	64%	39%	34%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.6 KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Që nga viti 2013, sondazhi i opinionit publik ka matur kënaqshmërinë e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike në një kapitull të veçantë. Numri i shërbimeve ka ndryshuar me kalimin e viteve. Në vitin 2022, në listë u shtua edhe Struktura e Posaçme e Antikorrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), duke e çuar në 18 numrin e shërbimeve publike bazë dhe administrative.

Në shërbimet bazë janë shërbimet e shëndetit publik, shërbimet e arsimit publik (përfshirë atë parashkollor), furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit përfshirë edhe mbledhjen e mbetjeve), shërbimet e emergjencës (zjarrfikësja, ambulanca etj.), shërbimet gjyqësore, shërbimet e policisë. Për të vlerësuar më mirë kënaqshmërinë me shërbimet e emergjencës, ato u ndanë në “Shërbimet e emergjencës: ambulanca” dhe “Shërbimet e emergjencës: zjarrfikësi”, duke bërë të mundur një vlerësim të veçantë për të dy. Në shërbimet administrative bëjnë pjesë shërbimet e ndihmës sociale, shërbimet e punësimit (Agjencia Kombëtare e Punësimit AKP), shërbimet e pronësisë (Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK: ish-ZRPP dhe ALUIZNI), shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e sigurimeve shoqërore (Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH), shërbimet e transportit rrugor (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor DPSHTRR), regjistrimi dhe licencimi i biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit QKB), lejet e ndërtimit.

Pyetjet e tjera u fokusuan në ankesat e të anketuarve për shërbimin e ofruar, kanalet për të bërë ankesa si në platformën e bashkëqeverisjes www.shqiperiaqeduam.al, dhe përgjigja nga ofruesit e shërbimeve publike. Ky kapitull përmbyllet me një vlerësim të ndjenjës së përditshme të sigurisë të qytetarëve dhe tre shtytësit kryesorë të mungesës së sigurisë.


KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE BAZË

Në vitin 2022, në mesatare, më pak se gjysma e të anketuarve (39.1%) ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me ofrimin e shërbimeve publike bazë. Shërbimet e arsimit publik, furnizimit me ujë, dhe pastrimit si dhe shërbimet e ofruara nga institucionet e kujdesit shëndetësor u raportuan më shpesh si të kënaqshme në krahasim me shërbimet e policisë, transportit publik dhe ato gjyqësore. Krahasuar me vitin 2021, përqindjet e kënaqshmërisë me shërbimet publike për pjesën më të madhe të shërbimeve bazë dhe administrative të matura nga ky sondazhi ranë.

Gjatë vitit 2022, mesatarisht¹, 39.1% e të anketuarve ishin të “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet publike bazë që u ishin ofruar qytetarëve (41.9% në 2021; 38% në 2020), ndërkohë që 42% raportuan se ishin “të pakënaqur” dhe “shumë të pakënaqur” me shërbimin e ofruar.

46.4% e të anketuarve ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet e ofruara nga institucionet e arsimit publik (përfshirë parashkollorin). E njëjta përqindje të anketuarish ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimin e furnizimit me ujë dhe 46.2% e të anketuarve ishin të kënaqur me shërbimin e pastrimit. Pothuajse e njëjta përqindje (43.4%) raportuan se ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet e kujdesit shëndetësor. Përqindja e kënaqshmërisë me shërbimet e emergjencës mjekësore (ambulancat) ishte më e lartë (39.4%) sesa me atë të zjarrfikësit (36.4%). Shërbimet e policisë (35.9%), transportit publik (31.8%), dhe ato gjyqësore (25.8%) – ngjashëm me shifrat e vitit 2021 – mbetën me vlerësimet më të ulëta mes shërbimeve publike bazë të ofruara për qytetarët në vitin 2022. Shih Figurën 44 për vlerësimin e të gjitha shërbimeve publike bazë për vitin 2022.


¹ Mesatarja e vlerësimit të kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike bazë të marra së bashku.

Figura 44: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2022

Baza: N = 2500 për të gjitha institucionet

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE BAZË NË VITE

Nga një këndvështrim krahasues, mesatarisht, më pak se gjysma e të anketuarve kanë qenë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me ofrimin e shërbimeve publike bazë gjatë gjithë periudhës 2016-2022 duke qëndruar brenda një përqindjeje të ngjashme prej 38-42% në katër vitet e fundit (2019-2022).

Figura 45: Përqindja e të gjithë të anketuarve “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet publike bazë (2016-2022)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


KËNAQSHMËRIA ME SHËRBIMET PUBLIKE ADMINISTRATIVE 2022

Në përgjithësi, 56% e qytetarëve shqiptarë që kishin marrë një shërbim administrativ në vitin 2022 ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimin, veçanërisht kur bëhej fjalë për gjendjen civile (52%), sigurimet shoqërore (39.4%) dhe transportin rrugor (38.5%). Gjithsesi, shifrat për gjendjen civile janë ulur ndjeshëm, -8 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2021.

Mesatarisht, 34.3% e të gjithë të anketuarve ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me dhënien e shërbimeve publike administrative - duke shënuar një rënie të lehtë krahasuar me gjetjet e vitit 2021 (37%) dhe duke arritur nivelin e vitit 2019 (33% në 2020; 34.5% në 2019).

Pak më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me dhënien e shërbimeve të gjendjes civile, pasuar nga 39.4% e të anketuarve që ishin të kënaqur me shërbimet e sigurimeve shoqërore dhe 38.5% që ishin të kënaqur me dhënien e shërbimeve të transportit rrugor. Shërbimet e dhëna nga shërbimet pronësore (30.8%), asistenca sociale (30.5%), punësimi (29.7%), biznesi (27.3%) dhe lejet e ndërtimit (25.9%) u vlerësuan si më pak të kënaqshme në vitin 2022. Shih Figurën 46 për vlerësimin e të gjitha shërbimeve administrative.

Figura 46: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2022



Baza: Shërbimet e asistencës sociale (N = 2318); Shërbimet e punësimit (N = 2304); Shërbimet e pronësisë (N = 2317); Gjendja civile (N = 2359); Sigurimet shoqërore (N = 2343); Transporti rrugor (N = 2312); Regjistrimi i biznesit (N = 2281); Lejet e ndërtimit (N = 2277).

Kur shohim përgjigjet e përdoruesve faktikë të shërbimeve publike administrative, mesatarisht², 56.1% ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimet publike administrative – përqindje dukshëm më e lartë se përqindja e përgjithshme e kënaqshmërisë (34.3%) e raportuar nga të gjithë të anketuarit.

² Përqindja i referohet nivelit mesatar të kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike administrative të marrë së bashku mes të anketuarve që kishin përdorur shërbimet në vitin 2022.

Shifrat e vitit 2022 tregojnë se tre shërbimet administrative më të përdorura nga pjesëmarrësit ishin shërbimi i gjendjes civile (46%), shërbimi i sigurimeve shoqërore (34.4%) dhe shërbimet që lidhen me transportin rrugor (30.6%). Nga ana tjetër, shërbimet më pak të përdorura ishin ato të asistencës sociale (22.3%), lejet e ndërtimit (13.4%) dhe regjistrimi dhe licencimi i biznesit (12.1%).

Në Tabelën 18 më poshtë evidentohet se nivelet e kënaqshmërisë për ata që kishin faktikisht përdorur shërbimet e gjendjes civile (74.7%), të transportit rrugor (63.4%) dhe ato të sigurimeve shoqërore (61.9%) ishin shumë më të larta se sa niveli i përgjithshëm i raportuar nga të gjithë të anketuarit, përkatësisht 52%, 38.5% dhe 39.4%. Një dallim më i vogël u vu re mes nivelit të kënaqshmërisë së përdoruesve të shërbimeve të punësimit (44.2%) dhe pronave (44.3%) dhe vlerësimit të të gjithë të anketuarve - përkatësisht 29.7% dhe 30.8%, ndonëse me një diferencë prej 5 pikë përqindjeje ose më shumë.

Tabela 18: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative (2022)

	Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë 2022	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në in 2022	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin në 2022
Shërbimet e asistencës sociale	30.5%	22.3%	51.8%
Shërbimet e punësimit	29.7%	24.5%	44.2%
Shërbimet e pronësisë	30.8%	30.5%	44.3%
Shërbimet e gjendjes civile	52%	46%	74.7%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	39.4%	34.4%	61.9%
Shërbimet e transportit rrugor	38.5%	30.6%	63.4%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	27.3%	12.1%	57.6%
Lejet e ndërtimit	25.9%	13.4%	50.6%

*Shënim: Ngjyra e gjelbër përfaqëson përmirësim prej >5 p.p. krahasuar me nivelin e përgjithshëm të kënaqshmërisë.

KRAHASIMI DEMOGRAFIK PËR KËNAQSHMËRINË ME DHËNIEN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Analiza demografike për dhënie të shërbimeve publike bazë mbështetet në nivelin e kënaqshmërisë së të gjithë të anketuarve, ndërsa analiza për dhënie të shërbimeve publike administrative bazohet vetëm në shkallën e kënaqshmërisë së përdoruesve faktikë të këtyre shërbimeve.

Tre gjetjet kryesore për të dy llojet e shërbimeve janë si më poshtë. Së pari, gjetjet tregojnë se nuk kishte asnjë ndryshim mes grave dhe burrave për sa i përket nivelit të kënaqshmërisë së tyre për të gjitha shërbimet publike, qofshin ato bazë apo administrative. Së dyti, të punësuarit në sektorin publik ishin më të prirur për të qenë të kënaqur me dhënie të të gjitha shërbimeve publike bazë dhe administrative të matura në këtë sondazh. Së fundi, të anketuarit që banojnë në zonat urbane dhe rurale priren të kenë nivele të ngjashme kënaqshmërie për të gjitha shërbimet bazë dhe administrative.

Kur i referohemi dallimeve demografike për shërbimet bazë, të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç që ishin të kënaqur me dhënie të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të urgjencës ishin më të shumtë në


përqindje. Të anketuarit me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë ishin më të kënaqur me dhënien e të gjitha shërbimeve bazë të listuara, përveç transportit publik.

Për sa i përket dallimeve ndërmjet përdoruesve faktikë të shërbimeve administrative, rezultatet tregojnë se të anketuarit e moshës 18-35 vjeç ishin më të prirur të ishin të kënaqur me shërbimin e asistencës sociale, punësimin, pronave, sigurimeve shoqërore, transportit rrugor dhe regjistrimit të biznesit. Ndërkohë, të anketuarit me diplomë universitare ishin më shpesh të kënaqur me shërbimin e asistencës sociale dhe të punësimit se grupet e tjera sipas nivelit arsimor.

KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE: PËRDORUESIT E SHËRBIMEVE KRAHASUAR ME TË GJITHË TË ANKETUARIT

Përdoruesit e shërbimeve publike administrative kanë raportuar shifra dukshëm më të larta se niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë të raportuar nga të gjithë të anketuarit gjatë viteve 2019-2022, duke ruajtur një trend pozitiv dhe duke arritur një shkallë kënaqshmërie prej 56% në 2022.

Figura 47: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative: Përdoruesit përkundërt gjithë të anketuarve (2019 – 2022)



*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


PARAQITJA E ANKESAVE

Vetëm 13.4% e të anketuarve kanë dorëzuar një ankesë tek institucioni që ka dhënë shërbimin publik, përqindje e ngjashme me atë të raportuar në sondazhin e vitit 2021 (15.1%).

Gjatë vitit 2022, vetëm 13.4% e të anketuarve kanë dorëzuar një ankesë tek institucioni që ka dhënë shërbimin publik, përqindje e ngjashme me atë të raportuar në sondazhin e vitit 2021 (15.1%), ndërsa 86.6% nuk kanë dorëzuar ankesë. Nuk ka dallime të mëdha në përqindjet e grave (12%) dhe burrave (15%) që raportojnë se kanë dorëzuar ankesa. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç, studentët dhe ata me të ardhura mujore 50 000

lekë ose më shumë ishin më të prirur se grupet e tjera demografikë të shpreheshin se kanë dorëzuar ankesë gjatë vitit 2022 për një shërbim të marrë nga institucionet.

Figura 48: Përqindja e të anketuarve që kishin bërë ankesë tek institucionet (2016–2022)



Baza: 2016 (N = 1627); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1628); 2019 (N = 2491); 2020 (N = 2488); 2021 (N = 2494); 2022 (N=2491).

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


PLATFORMË E BASHKËQEVERISJES SHQIPERIAQEDUAM.AL

Vetëm 9.5% e shqiptarëve të anketuar kanë përdorur platformën online të bashkëqeverisjes, www.shqiperiaqeduam.al, për të një ankesë në vitin 2022. 31.8% e atyre që thanë se kanë një ankesë te 'shqiperiaqeduam.al' thanë se ankesa ishte trajtuar.

Në vitin 2022, më pak se një në dhjetë të anketuar (9.5%) raportuan se kanë përdorur platformën online të bashkëqeverisjes, [shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al), për të një ankesë, një përqindje pak më e ulët se në vitin 2021 (12%). Kështu, 90.5% nuk kishin ankesë në këtë platformë në vitin 2022.

Të anketuarat gra (9%) dhe ata burra (10%) ishin njësoj të prirur të bënin ankesa përmes platformës online. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç, studentët dhe ata me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë prireshin më shumë të ankesa nëpërmjet platformës [shqiperiaqeduam.al](http://www.shqiperiaqeduam.al).

Figura 49: ankesa tek platforma e bashkëqeverisjes 'www.shqiperiaqeduam.al' (2022)



Baza: N = 2487


Mes atyre të anketuar që kishin dorëzuar ankesë në platformën 'shqiperiaqeduam.al' 31.8% thanë se u ishte trajtuar ankesa (71 nga 237), përqindje e ngjashme me vitin 2021 (32.2%) dhe 12 pikë përqindjeje më pak se rezultatet e vitit 2020 (44%).

INSTITUCIONET NË SHQIPËRI TRAJTOJNË ANKESAT E QYTETARËVE (2022)

Pothuajse gjysma e të anketuarve (46.8%) nuk besonin se institucionet publike i trajtojnë ankesat e qytetarëve, 24.9% thanë 'Po', ndërkohë që 28.2% nuk e dinin.

Nuk ka dallime të mëdha të përqindjet e grave (26%) dhe burrave (24%) që besonin se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve. Ndër të anketuarit që besonin se institucionet publike i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve, të anketuarit me diplomë universitare (ose pasuniversitare), ata që punojnë në institucione publike dhe ata me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë ishin më të shumtë në përqindje.

Figura 50: Institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve (2016 - 2022)



Baza: 2016 (N = 1259); 2017 (N = 1599); 2018 (N = 1565); 2019 (N = 2464); 2020 (N = 2475); 2021 (N = 2478); 2022 (N=2500).
 Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


SIGURIA NË JETËN E PËRDITSHME

59.3% e qytetarëve të anketuar thanë se nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme, një rënie e madhe me 12 pikë përqindjeje nga 71.6% që ishte në vitin 2021. Tre arsyet kryesore të ndjenjës së pasigurisë janë kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standard, dhe pasiguria e vendit të punës.

Rreth gjashtë në dhjetë të anketuar (59.3%) nuk ndiheshin të sigurt në jetën e përditshme, një rënie e konsiderueshme prej 12 pikë përqindjeje krahasuar me 71.6% të regjistruar në vitin 2021. Pjesa e mbetur prej 40.7% thanë se në përgjithësi ndiheshin të sigurt.

Në Figurën 51 jepet perceptimi i qytetarëve për sigurinë e tyre siç është raportuar në sondazhet e viteve 2016-2022. Kjo tregon një tendencë të qëndrueshme në rënie mes viteve 2017-2021, ku viti 2021 shënon rënie më të vogël vjetore të perceptimit të qytetarëve për sigurinë (-2 pikë përqindjeje), krahasuar me rënie më të konsiderueshme prej 10 pikë përqindjeje mes viteve 2017 dhe 2020. Gjithsesi, në sondazhin e vitit 2022 perceptimi i publikut për sigurinë e ndryshoi trendin me një rritje të dukshme në 41% krahasuar me periudhën 2019-2021.

Figure 51: Perceived safety in everyday life (2016–2022)



Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=2500); 2020 (N=2492); 2021 (N = 2490); 2022 (N=2487).

Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Kur u pyetën për arsyt e ndjenjës së pasigurisë në vitin 2022, faktori më i përmendur nga të anketuarit ishte kriminaliteti (63%), i ndjekur nga shëndetësia pa cilësi e standard (45%) dhe padrejtësia (39%). Arsye të tjera që u cituan për pasigurinë ishin pasiguria e vendit të punës (37%), politika (26%) dhe pabarazia e pasurisë (18%). Në Tabelën 19 më poshtë jepet renditja e plotë e arsyeve për ndjenjën e pasigurisë së përditshme gjatë viteve 2016-2022.

Table 19: Reasons for feeling unsafe (2016–2022)

Faktorët për ndjenjën e pasigurisë	2016	2017	2018	2019*	2020	2021	2022
Kriminaliteti (vjedhjet, grabitjet)	49%	58%	71%	67%	59%	73%	61%
Shëndetësia pa cilësi e standard	11%	30%	50%	49%	49%	43%	45%
Pasiguria e vendit të punës	X	42%	52%	36%	41%	33%	37%
Padrejtësia	11%	32%	45%	36%	37%	35%	39%
Ndjenja e pasigurisë për shkak të fatkeqësive natyrore (p.sh., tërmetet, pandemia)	X	X	X	X	27%	22%	13%
Politika	5%	29%	45%	28%	23%	17%	26%
Pabarazia në pasuri	3%	23%	23%	16%	18%	15%	18%
Ndotja	3%	12%	20%	17%	12%	16%	13%
Përdorimi i lëndëve narkotike	6%	23%	29%	15%	9%	13%	11%
Trafiku	7%	11%	13%	13%	8%	13%	8%
Dhuna në familje	3%	15%	19%	7%	6%	9%	9%
Mungesa e lirisë së fjalës	1%	5%	11%	4%	3%	3%	5%
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	1%	6%	12%	3%	3%	4%	6%
Diskriminimi për shkak të gjinisë, besimit fetar, pasurisë, etj.	X	5%	7%	3%	1%	1%	3%

Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=1613); 2020 (N=1713); 2021 (N=1776); 2022 (N=1460).

Shënim: Lejohen disa përgjigje; përqindjet nuk plotësojnë koeficientin 100%.

* Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 20: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas karakteristikave demografike (2022)

		Shërbimet publike (të gjithë të anketuarit)								
		Shëndetësia	Arsimi	Furnizimi me ujë	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencë: ambulanca	Emergjencë: zjarrfikësi	Gjyqësori	Policia
Gjithsej (% e kënaqshmërisë)		43%	46%	46%	32%	46%	39%	36%	26%	36%
Gjinia										
Gra		44%	48%	49%	35%	47%	41%	37%	28%	37%
Burra		43%	44%	43%	29%	46%	38%	35%	24%	34%
Mosha										
18-25 vjeç		43%	49%	41%	34%	39%	35%	36%	27%	32%
26-35 vjeç		45%	47%	49%	34%	50%	41%	39%	27%	37%
36-45 vjeç		46%	51%	47%	29%	46%	42%	38%	27%	41%
46-55 vjeç		42%	46%	46%	31%	45%	38%	33%	27%	37%
56-65 vjeç		37%	40%	43%	28%	47%	34%	31%	18%	30%
Mbi 66 vjeç		46%	42%	53%	36%	51%	45%	39%	26%	35%
Niveli arsimor										
Me arsim deri 8/9-vjeçar		40%	42%	41%	27%	39%	38%	35%	23%	32%
Me arsim të mesëm		42%	47%	47%	33%	48%	38%	36%	25%	36%
Me arsim universitar		47%	49%	49%	34%	49%	41%	37%	28%	38%
Statusi i punësimit										
I/e punësuar	Gjithsej	47%	50%	49%	33%	50%	42%	38%	28%	40%
	Sektori publik	60%	60%	59%	47%	61%	52%	47%	39%	52%
	Sektori privat	42%	46%	45%	29%	46%	39%	36%	24%	35%
I/e papunë		36%	41%	41%	27%	39%	33%	32%	22%	30%
Studentë		39%	48%	44%	34%	37%	31%	36%	24%	29%
Pensionist		41%	39%	47%	33%	48%	41%	35%	24%	32%
Niveli i të ardhurave										
Pa të ardhura		35%	42%	41%	28%	38%	33%	33%	22%	30%
Deri në 30,000 lekë		43%	43%	47%	35%	47%	39%	35%	26%	35%
30,001–50,000 lekë		46%	51%	47%	33%	49%	42%	36%	28%	40%
50,001–70,000 lekë		52%	54%	52%	37%	55%	47%	42%	32%	44%
Mbi 70,001 lekë		46%	42%	47%	23%	43%	38%	41%	18%	35%
Vendbanimi										
Urban		42%	46%	44%	31%	45%	38%	35%	24%	35%
Rural		47%	48%	51%	33%	48%	42%	39%	29%	38%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar)..

* Përqindja është llogaritur si shumatore e përqindjes "i kënaqur" dhe "shumë i kënaqur".

Tabela 21 : Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative sipas karakteristikeve demografike (2022)

		Shërbimet administrative (vetëm përdoruesit)							
		Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Social insurance services	Transporti rrugor	Regj. e licencimit i biznesit	Lejet e ndërimit
Gjithsej (% e kënaqshmërisë)		52%	44%	44%	75%	62%	63%	58%	51%
Gjinia									
Gra		57%	46%	49%	75%	63%	69%	66%	59%
Burra		53%	46%	43%	78%	65%	63%	57%	51%
Mosha									
18-25 vjeç		64%	40%	64%	69%	72%	71%	70%	55%
26-35 vjeç		65%	50%	50%	81%	66%	71%	63%	56%
36-45 vjeç		56%	53%	45%	79%	62%	60%	63%	57%
46-55 vjeç		50%	41%	42%	77%	66%	60%	58%	53%
56-65 vjeç		50%	39%	35%	74%	51%	63%	59%	43%
Mbi 66 vjeç		49%	42%	46%	72%	68%	63%	50%	75%
Niveli arsimor									
Me arsim deri 8/9-vjeçar		50%	44%	50%	68%	55%	56%	53%	51%
Me arsim të mesëm		52%	40%	38%	77%	65%	62%	60%	53%
Me arsim universitar		66%	52%	51%	80%	69%	70%	66%	59%
Statusi i punësimit									
I/e punësuar	Gjithsej	63%	53%	46%	81%	67%	68%	59%	57%
	Spektori publik	77%	75%	63%	89%	75%	80%	71%	71%
	Spektori privat	55%	42%	39%	78%	64%	62%	57%	49%
I/e papunë		44%	32%	42%	66%	55%	60%	78%	42%
Studentë		48%	25%	72%	69%	70%	58%	62%	57%
Pensionist		54%	48%	40%	73%	62%	60%	50%	71%
Niveli i të ardhurave									
Pa të ardhura		41%	28%	46%	66%	57%	60%	80%	43%
Deri në 30,000 lekë		58%	44%	45%	77%	66%	61%	50%	58%
30,001–50,000 lekë		64%	57%	48%	81%	68%	70%	64%	56%
50,001–70,000 lekë		78%	66%	48%	85%	66%	73%	68%	68%
Mbi 70,001 lekë		43%	30%	34%	76%	50%	58%	52%	33%
Vendbanimi									
Urban		52%	45%	45%	75%	62%	65%	64%	54%
Rural		59%	47%	47%	79%	67%	66%	59%	57%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë dallimet >5 p.p. ndaj totalit të përgjigjeve

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.7 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT


Dixhitalizimi i shërbimeve publike mbeti një nga prioritetet kryesore për qeverinë shqiptare në vitin 2022. Për të kuptuar përvojat e qytetarëve me shërbimet elektronike, pyetjet u përqendruan te njohuritë dhe përdorimi i faqes së internetit të bashkisë dhe portalit e-Albania. Ashtu si në sondazhin e vitit 2021, shërbimet elektronike u vlerësuan sipas kriterëve të mëposhtme: funksionalitetit, thjeshtësisë së përdorimit, mundësisë për të bërë komente/sugjerime dhe kohës për marrjen e shërbimit. Sondazhi i Opinioneve Publike për vitin 2022 kishte edhe një grup të ri pyetjesh që fokusoheshin në mënyrën se si përdoruesit shqiptarë qaseshin në portalin e-Albania - nëse e bënë vetë apo me ndihmë nga dikush tjetër - dhe nëse të anketuarit në Shqipëri besonin se të dhënat e tyre personale janë administruar siç duhet nga aktorët publikë dhe nga sektori privat.

FAQJA E INTERNETIT E BASHKIVE

Në vitin 2022, 64.9% e shqiptarëve të anketuar ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti, përqindje më e lartë se në vitin 2021. Përqindja e atyre që përdornin faqen e internetit të bashkisë së tyre ishte 39.4%. Arsyeja kryesore për përdorimin e faqes së internetit të bashkisë ku jetojnë ishte “Marr informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen”.

64.9% të anketuarve (65.4% e grave dhe 64.4% e burrave) kishin dijeni se bashkia ku jetojnë ka një faqe interneti, përqindje më e lartë se në vitin 2021 (64.9% me 59.7%), ndërkohë 32.7% deklaruan se nuk e dinin që bashkia e tyre kishte faqe zyrtare në internet.

Figura 52: Dijeni për faqen e internetit të bashkisë (2022)




Baza: N = 2492

Grupmoshat më të reja, të anketuarit me diplomë universitare ose pasuniversitare, punonjësit e sektorit publik, banorët e zonave urbane dhe studentët prireshin më shumë për të qenë në dijeni të ekzistencës së faqes së internetit të bashkisë së tyre.

39.4% e të anketuarve kanë deklaruar se e kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë së tyre, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2021 (40.7%). Më shumë se gjysma e të anketuarve (60.6%) kanë raportuar se nuk e kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë ku jetojnë.

Figura 53: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2022)



Baza: N=1616


Gratë ishin më të prirura se burrat të përdornin faqen e internetit të bashkisë. Gjithsesi, dallimi nuk ishte i madh (40.6% me 38.1%). Të anketuarit me diplomë universitare (apo pasuniversitare), të punësuar në sektorin publik dhe studentët kishin më shumë gjasa të deklarorin se kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë.

PËRDORIMI I FAQES SË INTERNETIT TË BASHKISË NË VITE

Në Figurën 54 jepen të dhënat në vite, nga viti 2014 deri në vitin 2022. Përqindja e të anketuarve që raportuan se ishin në dijeni se bashkia ku jetojnë kishte faqe zyrtare në internet është rritur ndjeshëm që nga viti 2014, edhe pse me disa luhatje.


Ndërkohë, përdorimi i faqes zyrtare të bashkisë nuk është rritur me të njëjtën përqindje si dijenia e ekzistencës së kësaj faqeje.

Figura 54: Përqindja e të anketuarve që janë në dijeni që bashkia ka një faqe interneti (2014-2022)



Baza: 2015 (N=1565); 2016 (N=1618); 2017 (N=1640); 2018 (N=1638); 2019 (N=2493); 2020 (N=2500); 2021 (N=2500); 2022 (N=2492)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Figura 55: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë (2016-2022)

Baza: 2016 (N=692), 2017 (N=638), 2018 (N=654), 2019 (N=1556), 2020 (N=1575), 2021 (N=1493), 2022 (N=1616)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

CILËSIA DHE ARSYET E PËRDORIMIT TË FAQES SË INTERNETIT TË BASHKISË

Arsyeja kryesore që u dha për përdorimin e faqes së internetit të bashkisë në vitin 2022 ishte “Marr informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen”.

Arsyeja kryesore që u citua për përdorimin e faqes së internetit të bashkisë në vitin 2022 ishte “Marr informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen” (51.6%), ndjekur nga “Marr informacion mbi programet / aktivitetet në qytetin tim” (37.7%), “Marr informacion për buxhetin e bashkisë” (18.9%), “Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve” (13.9%), dhe “Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak” (12.7%).

Tabela 22: Arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (2022)


	N	%
Marr informacion për buxhetin e bashkisë	147	18.9
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	108	13.9
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak	99	12.7
Marr informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	402	51.6
Marr informacion mbi programet / aktivitetet në qytetin tim	294	37.7
Tjetër*	10	1.3

* Tjetër: Si ato për të marrë informacione për vende pune, informacion për kreditë e buta

E-QEVERISJA NË SHQIPËRI

Ashtu si në vitin 2021, shumica dërrmuese e të anketuarve (90.7%) raportuan se ishin në dijeni që qeveria ofron shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania. Megjithatë, më pak se gjysma (47.9%) raportuan se mund të kyçeshin në portalin e-Albania pa ndihmën e të tjerëve. Përqindja e të anketuarve që i cilësuan shërbimet si funksionale, të lehta për t'u përdorur dhe efçente në kohë ishte më e ulët në 2022 sesa në 2021.

Shumica e të anketuarve, 90.7% (90.6% e grave dhe 90.8% e burrave), kishin dijeni që administrata e qeverisë ofron shërbime elektronike përmes portalit e-Albania, përqindje më e madhe se ajo e vitit 2021 (89.4%).


Figura 56: Dijeni për portalin e-Albania (2022)

Baza: N=2494

Grupmoshat e reja, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar, studentët, të punësuarit në sektorin publik, dhe banorët e zonave urbane kishin më shumë gjasa të deklaronin se ishin në dijeni të portalit e-Albania.

Ndër të anketuarit që kishin dijeni për portalin e-Albania, 82.9% raportuan se kishin marrë shërbime elektronike përmes portalit në vitin 2022, përqindje më e madhe se në vitin 2021 (82.9% me 80.1%).

Figura 57: Përqindja e të anketuarve që kanë marrë shërbime elektronike përmes portalit e-Albania (2022)



Në vitin 2022 raportuan se kanë marrë shërbime elektronike përmes portalit e-Albania një përqindje më e lartë e grave se e burrave. Gjithsesi, dallimi mes tyre nuk ishte domethënës (83.8% me 81.9%). Grupmoshat më të reja, të anketuarit me arsimin universitar apo pasuniversitar, studentët dhe punonjësit e sektorit publik kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin marrë shërbime nëpërmjet portalit e-Albania.

U bë një pyetje pasndjekëse që u fokusua në mënyrën se si të anketuarit kyçen në portalin e-Albania—nëse e bëjnë vetë apo me ndihmë nga të tjerë. Më pak se gjysma (47.9%) kanë raportuar se janë kyçur në portalin e-Albania “gjithmonë vetë”, 20.5% “zakonisht vetë (rrallëherë me ndihmën e dikujt tjetër)”, 15.9% “zakonisht me ndihmë nga dikush tjetër” dhe 15.7% “gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër”. Këto rezultate jepen në Tabelën 23.

Tabela 23: Aksesi në shërbimet e portalit e-Albania (2022)

	N	%
Gjithmonë vetë	889	47.9
Zakonisht vetë (rrallëherë me ndihmën e dikujt tjetër)	381	20.5
Zakonisht me ndihmë nga dikush tjetër (rrallëherë i marr vetë)	296	15.9
Gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër	291	15.7


Baza: N=1857

14.0% e grave dhe 17.4% e burrave raportuan se e kanë përdorur portalin e-Albania ‘gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër’. Të anketuarit mbi 55 vjeç, ata me arsim 8/9-vjeçar, dhe ata që banojnë në zonat rurale kishin më shumë gjasa të raportonin se e kanë përdorur portalin e-Albania ‘gjithmonë me ndihmë nga dikush tjetër’. 71.3% e të anketuarve mbi 65 vjeç dhe 45.9% e të anketuarit me arsim deri 8/9-vjeçar kanë raportuar se ‘gjithmonë’ janë kyçur në portalin e-Albania me ndihmën e të tjerëve.

Ashtu si në sondazhin e vitit 2021, shërbimet elektronike u vlerësuan sipas kriterëve të mëposhtme: funksionalitetit, thjeshtësisë së përdorimit, mundësisë për të bërë komente/sugjerime dhe shkurtimit të kohës së marrjes së shërbimit. 86.4% e të anketuarve i karakterizuan shërbimet si funksionale, përqindje dukshëm më

e ulët se në vitin 2021 (86.4% me 92.6%; një diferencë prej -6.2 pikë përqindje). Po ashtu, përqindja e të anketuarve që i karakterizuan shërbimet si të lehta për t'u përdorur ishte dukshëm më e ulët në vitin 2022 sesa në vitin 2021 (59.3% me 69%; një diferencë prej -9.7 pikë përqindje). Një përfundim i ngjashëm evidentohet për shkurtime të kohës së marrjes së shërbimit. 85.4% e të anketuarve ishin dakord se shërbimet elektronike shkurtojnë kohën e marrjes së shërbimit, krahasuar me 89.6% në 2021, ku kemi një diferencë prej 4.2 pikë përqindjeje. 52.6% e të anketuarve ishin dakord se shërbimet elektronike u japin qytetarëve mundësinë për të shprehur komente/sugjerime, përqindje e ngjashme me atë të vitit të kaluar (52.4%). Dallimet sipas grupeve gjinore për të katër kriteret nuk ishin domethënëse. Të anketuarit me aftësi të kufizuara, krahasuar me ata që nuk kishin aftësi të kufizuara, kishin më pak gjasa t'i vlerësonin shërbimet elektronike si funksionale, të lehta për t'u përdorur, që shkurtojnë kohë dhe që ofrojnë mundësinë për të shprehur komente/sugjerime.

Figura 58: Vlerësimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2022)




Baza: N1=1839, N2=1821, N3=1816, N4=1829.

E-QEVERISJA NË SHQIPËRI NË VITE

Përqindja e shqiptarëve që kanë dijeni për portalin e-Albania është rritur ndjeshëm që nga shtimi i pyetjes në 2018, me shifra që arrijnë mesatarisht 91% në tre vitet e fundit. Po kështu, përqindja e shqiptarëve që kanë marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania është rritur ndjeshëm, me një shifër prej 75% të regjistruar për vitin 2022.

Figura 59: Përqindja e të anketuarve që kanë dijeni për portalin e-Albania (2018-2022)



Baza: 2018 (N=1622); 2019 (N=2468); 2020 (N=2492); 2021 (N=2495); 2022 (N=2494)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Për shumicën dërrmuese të të anketuarve, mbrojtja e të dhënave personale ishte e rëndësishme. Megjithatë, më shumë se gjysma e të anketuarve nuk besonin se të dhënat e tyre personale janë administruar siç duhet nga aktorët publikë dhe nga sektori privat.

Të anketuarit u pyetën nëse mbrojtja e të dhënave personale ishte e rëndësishme për ta dhe sa besonin ata se të dhënat e tyre personale janë administruar siç duhet nga aktorët publikë dhe sektori privat.

Vetëm 27 të anketuar në këtë sondazh (1.1%) raportuan se mbrojtja e të dhënave personale nuk ishte “aspak e rëndësishme”. Për shumicën dërrmuese mbrojtja e të dhënave personale ishte ose “shumë e rëndësishme” (62.6%), “e rëndësishme” (27.7%) ose “pak e rëndësishme” (3% e të anketuarve). Dallimet sipas gjinisë nuk ishin domethënëse.


Figura 60: Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale (2022)



Baza: N=2500

Më shumë se gjysma e të anketuarve, 59.8% (58.8% e grave dhe 60.9% e burrave), nuk besojnë se të dhënat e tyre personale janë administruar siç duhet nga aktorët publikë.


Figura 61: Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga aktorët publikë



Baza: N=2500

E njëjta përqindje, 58.8% (58.1% e grave dhe 59.4% e burrave), nuk kishin besim se të dhënat e tyre personale janë administruar siç duhet nga sektori privat.

Figura 62: Niveli i besimit në miradministrimin e të dhënave personale elektronike/ digjitale nga sektori privat



Baza: N=2500

4.8 PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE

Shqipëria ka bërë përparim të madh për sa i përket përfaqësimit të grave në vendimmarrjen politike. Rreth 44% e këshilltarëve vendorë dhe 36% e deputetëve janë gra¹. Rritja e përfaqësimit të grave në politikë pritet të formësojë perceptimet dhe qëndrimet ndaj barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes sociale në vend. Kapitulli i sondazhit për gjithëpërfshirjen gjinore dhe sociale vlerëson perceptimet e qytetarëve në lidhje me dallimet gjinore në aksesin e shërbimeve publike dhe aftësinë për të mbajtur poste publike. Të anketuarit u pyetën nëse janë trajtuar ndryshe nga institucionet/nëpunësit publikë për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar apo për arsye të tjera. Pyetja e fundit në këtë pjesë synon të kuptojë bindjet e qytetarëve në lidhje me rritjen e numrit të grave në këshillat vendorë dhe ndikimin e tyre në qeverisjen vendorë.

PERCEPTIMI PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRINË SHQIPTARE


61.5% e të anketuarve në Shqipëri ishin dakord se ka barazi mes burrave dhe grave, një përqindje e ngjashme me atë të vitit 2021. Burrat prireshin të ishin më shumë dakord se ka barazi mes burrave dhe grave krahasuar me gratë.

Të anketuarëve u kërkua të vlerësonin se sa dakord ishin me tre pohimet për barazinë gjinore në Shqipëri duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh – nga 1 (plotësisht dakord) në 4 (aspak dakord).

Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”

61.5% e të anketuarve raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin e mësipërm, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2021 (61.5% me 60.6%). Burrat ishin më të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (67.3% me 56.1%).

Figura 63: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2022)




Baza: N = 2500

¹ INSTAT, Burrat dhe gratë në Shqipëri 2021 (2021), <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/barazia-gjinore/>.

Të punësuarit në sektorin publik, të anketuarit e zonave urbane dhe ata me arsim deri të mesëm kishin më shumë gjasa për të qenë dakord me këtë pohim.

Në Figurën 64 jepen perceptimet mbi dallimet gjinore në vite. Siç mund të shihet, të dhënat për vitet 2016-2022 tregojnë se përgjithësisht më shumë se gjysma e popullsisë në Shqipëri ishte dakord se ka barazi mes burrave dhe grave në shoqëri.

Figura 64: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016–2022)



Baza: 2016 (N = 1636); 2017 (N = 1623); 2018 (N = 1636); 2019 (N = 2487); 2020 (N = 2497); 2021 (N=2493); 2022 (N=2500)


*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

AKSESI TE SHËRBIMET PUBLIKE SIPAS GJINIVE

77.1% e të anketuarve besonin se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses në shërbimet publike, përqindje paksa më e lartë se në vitin 2021.

Pohimi 2: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”


77.1% e të anketuarve besonin se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses në shërbimet publike, përqindje paksa më e lartë se në vitin 2021 (77.1% me 74.8%).

Figura 65: 'Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike' (2022)

Baza: N=2500

Burrat ishin më të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (80.2% me 74.3%). Të anketuarit ishin, po ashtu, më të prirur për të qenë dakord me këtë pohim nëse punonin në sektorin publik apo banonin në zona urbane.

Të dhënat e sondazhit tregojnë se gjatë viteve 2016-2022 shumica e të anketuarve në Shqipëri besojnë se burrat dhe gratë kanë të njëjtën akses në shërbimet publike, pa dallime të mëdha në perceptimet e grave në krahasim me ato të burrave. Në Figurën 66 jepen gjetjet në vite.

Figura 66: 'Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike' (2016-2022)

Base: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1619); 2018 (N = 1624); 2019 (N = 2487); 2020 (N = 2496); 2021 (N = 2494); 2022 (N = 2500).

*Note: In 2019, the sampling method was changed to a nationally representative sample.


OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE SIPAS GJINIVE

Plot 72.4% e shqiptarëve të anketuar besonin se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave, përqindje më e ulët se në sondazhin e vitit 2021.

Pohimi 3: “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.”

72.4% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim – përqindje më e ulët se në vitin 2021 (72.4% me 76.6%). Burrat ishin më të prirur se gratë për të qenë dakord me këtë pohim (74.9% ndaj 69.9%).

Figura 67: ‘Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’ (2022)




Baza: N = 2500

Të anketuarit kishin më shumë gjasa për të qenë dakord me këtë pohim nëse punonin në sektorin publik apo banonin në zona urbane.

Në Figura 68 jepen dallimet e perceptuara sipas gjinisë në vite. Të njëjtat perceptime për aksesin në shërbimet publike janë të vërteta edhe për rastin e etikës dhe përkushtimit, megjithëse jo në të njëjtin model linear, me shumicën e shqiptarëve që kanë qenë dakord me pohimin gjatë viteve 2016-2022.

Figura 68: 'Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave' (2016–2022)



Baza: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1614); 2018 (N = 1636); 2019 (N = 2487); 2020 (N = 2492); 2021 (N = 2494); 2022 (N = 2500)

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

DISKRIMINIMI NGA INSTITUCIONET APO NËPUNËSIT PUBLIKË

Në vitin 2022, 14.6% e popullsisë raportoi se ishte trajtuar ndryshe nga një institucion ose nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar ose arsyeje tjetër - një rritje krahasuar me vitin 2021 (14.6% kundrejt 11.8%). Nga ata që ishin përballur me diskriminim në vitin 2022, shumica mendonin se ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës ose gjinisë së tyre.

Të anketuarit u pyetën nëse ishin trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, paaftësisë apo arsyeve të tjera. Gjithsej 14.6% e të anketuarve mendonin se janë trajtuar ndryshe në vitin 2022 për shkak të gjinisë së tyre (4.3%), moshës (5.3%), përkatësisë etnike (1.6%), orientimit seksual (0.2%), paaftësisë (1.2%), ose arsye të tjera (1.9%). 85.4% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se nuk janë trajtuar ndryshe, që është një përqindje më e vogël se në vitin 2021 (85.4% kundrejt 88.2%).

Tabela 24: Diskriminim nga institucioni (2022)

	N	%
Nuk jam trajtuar ndryshe	2126	85.4
Jam trajtuar ndryshe për shkak të*	363	14.6
<i>Gjinia</i>	108	4.3
<i>Mosha</i>	132	5.3
<i>Përkatësisë etnike</i>	41	1.6
<i>Orientimit seksual</i>	5	0.2
<i>Aftësisë së kufizuar</i>	30	1.2
<i>Tjetër*</i>	47	1.9

Baza: N = 2489

* Tjetër: Për shembull, diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, bindjeve politike, origjinës, dhe besimit fetar.

Gratë ishin më të prirura se burrat për të raportuar se janë trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë fizike apo për arsye të tjera (17% me 12.1%). Dallimi ishte më i theksuar për diskriminimin me bazë gjinore: 6.6% e grave dhe 2% e burrave raportuan se trajtoheshin ndryshe për shkak të gjinisë.

Anëtarët e pakicave kombëtare prireshin më shumë për të raportuar se janë trajtuar ndryshe për shkak të përkatësisë etnike (17.2% kundrejt 0.6%). Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit që raportuan se kishin një aftësi të kufizuar kishin më shumë gjasa të raportonin se janë trajtuar ndryshe për shkak të aftësisë së kufizuar (12.1% kundrejt 0.4%).


DISKRIMINIMI NGA INSTITUCIONET APO NËPUNËSIT PUBLIKË NË VITE

Për sa i përket diskriminimit në vite, gjetjet nxjerrin në pah se gjatë periudhës 2016-2022 përqindja e shqiptarëve që raportojnë se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, etnisë, moshës, gjinisë apo për arsye të tjera nuk ka ndryshuar shumë. Vlerat luhaten në 12-16%.

GRATË NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

77.5% e shqiptarëve të anketuar ishin të mendimit se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik, përqindje më e ulët se në vitin 2021.


77.5% e të anketuarve ishin të mendimit se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çfarëdo posti publik, përqindje më e ulët se në 2021 (81.8%). Një përqindje pothuajse e barabartë e të anketuarve thanë ose se gratë nuk janë aq të afta sa edhe burrat (11.1%), ose nuk e dinin nëse gratë janë po aq të afta sa dhe burrat për të mbajtur çfarëdo posti publik (11.4%). Në Figurën 69 jepen ndryshimet në vite. Përqindja e shqiptarëve që ishin dakord se gratë dhe burrat janë njëjloj të aftë për të mbajtur poste publike ka mbetur dukshëm e lartë që kur kjo pyetje u bë për herë të parë në vitin 2016. Vlerësimi më i ulët ishte 77% në 2019.

Figura 69: 'Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike' (2016-2022)

Baza: 2016, N=1635; 2017, N=1628; 2018, N=1632; 2019, N=2486; 2020, N=2498; 2021, N=2496; N=2495.

*Shënim: Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Gratë ishin më të prirura se burrat për të qenë dakord me këtë pohim (82.0% me 72.8%). Në Figurën 70 jepen dallimet mes gjinive.

Figura 70: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur poste publike (2022)

Baza: N=2498


Të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar, ata që janë të punësuar në sektorin publik, dhe studentët kishin më shumë gjasa për të qenë dakord me këtë pohim.

NDIKIMI I GRAVE NË QEVERISJEN VENDORE

Në vitin 2022, 58% e shqiptarëve besonin se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë ka një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore - shifër më e madhe se në vitin 2021.

Të anketuarit u pyetën nëse besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 58% e pjesëmarrësve në studim ishin dakord se do të kishte ndikim pozitiv; ndërkohë, 20.3% nuk ishin dakord dhe 21.8% u përgjigjën se nuk e dinin. Krahasuar me vitin 2021, përqindja që mendonin se do të kishte ndikim pozitiv është më e ulët (58% me 64%), ndërkohë që përqindja që thanë se nuk e dinin është më e lartë (21.8% me 18%). Në Figurën 71 jepen të dhënat ndër vite.

Figura 71: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë (2016-2022)



Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1631; 2018, N = 1633; 2019, N=2486; 2020, N = 2498; 2021, N = 2494; 2022, N = 2491.

***Shënim:** Në vitin 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Gratë ishin më të prirura se burrat për të qenë dakord me këtë pohim. Dallimi ishte mjaft i dukshëm: 67.0% me 48.4%. Të anketuarit kishin më shumë gjasa për të qenë dakord me këtë pohim nëse do të ishin të rinj apo studentë, nëse do të kishin arsim universitar apo pasuniversitar apo nëse do të ishin punonjës të sektorit publik.

SHTOJCA 1: KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT (2013-2022)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Gjinia										
Burra	45%	49%	50%	43%	51%	52%	49%	50.5%	50.6%	51.3%
Gra	55%	50%	50%	57%	49%	48%	51%	49.4%	49.3%	48.7%
Tjetër (shtuar në 2020)								<0.1%	0.1%	
Grupmosha										
18-25	14%	23%	22%	18%	19%	16%	19%	17.4%	15.2%	13.8%
26-35	14%	22%	25%	23%	23%	23%	26%	26.7%	25.4%	23.8%
36-45	14%	18%	16%	19%	19%	19%	20%	19.7%	21.9%	20.2%
46-55	19%	18%	17%	18%	19%	20%	16%	16.6%	17.0%	19.2%
56-65	20%	10%	11%	13%	11%	13%	12%	12.4%	12.5%	13.6%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%	9%	7%	7.2%	8.1%	9.4%
Vendbanimi										
Urban			81%	51%	50%	50%	70%	72.8%	70.7%	65.3%
Rural			19%	49%	50%	50%	30%	27.2%	29.3%	34.7%
Niveli arsimor										
Pa arsim + me arsim fillor	1%	1%	3%	6%	5%	7%	4%	4.0%	4.10%	4.6%
Mbaruar shkollën 8/9 - vjeçare	14%	15%	12%	19%	17%	23%	18%	18.3%	17%	17.3%
Mbaruar shkollën e mesme	40%	41%	40%	50%	50%	46%	44%	41.9%	42.9%	40.6%
Me diplomë universitare/ më lart	44%	42%	43%	24%	28%	24%	33%	35.3%	35.8%	36.9%
Statusi i punësimit										
I/E punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%	54%	57.3%	56.8%	57.3%
I/E papunë	20%	25%	28%	35%	34%	32%	25%	23.8%	20.6%	19.8%
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%	7%	6.5%	7.0%	6.4%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%	11%	10.9%	11.5%	12.4%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%	3%	0.4%	3.2%	3.2%

Sektori i punësimit								
Sektori publik	32%	29%	28%	25%	27.7%	27.7%	17.5%	
Sektori privat	64%	71%	69%	72%	70.4%	68.9%	42.9%	
Tjetër	4%		3%	3%	2.0%	3.5%	3.6%	
Të ardhurat e rregullta mujore individuale (Neto)								
Nuk kam të ardhura	34%	33%	37%	32%	29%	28.1%	24.7%	20.8%
Deri në pagën minimale	21%	25%	24%	28%	25%	19.0%	27.4%	23.8%
Mbi pagën minimale -50,000 lekë	29%	28%	25%	28%	28%	31.6%	25.7%	27.0%
50,001-70,000 lekë	6%	4%	5%	4%	7%	12.0%	13.9%	15.9%
Mbi 70,001 ALL	2%	1%	2%	<1%	2%	2.5%	2.5%	4.5%
A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?								
Po		9%	7%	6%	4.4%	5.8%	5.7%	
<i>Greke</i>		3.20%	2.70%	1.50%	1.1%	1.4%	0.8%	
<i>Maqedonase</i>		1.60%	1.10%	0.90%	0.6%	0.8%	0.5%	
<i>Arumune</i>		<0.1%	0.20%	0.20%	<0.1%	0.1%	0.3%	
<i>Rome</i>		2.30%	2.40%	1.50%	1.1%	1.7%	1.7%	
<i>Egjiptiane</i>		0.90%	0.20%	0.90%	0.4%	0.8%	1.1%	
<i>Malazeze</i>		0%	0%	0.10%	0.1%	0.1%	0.2%	
<i>Boshnjake</i>		0.20%	<0.1%	0.20%	0.2%	0.1%	0.1%	
<i>Serbe</i>		0%	0%	<0.1%	<0.1%	0.0%	0.0%	
<i>Bullgare</i>		<0.1%	0.10%	0.3%	0.1%	<0.1%	0.3%	
Jo		90%	92%	93%	93.5%	92.8%	91.4%	
A jeni simpatizant i ndonjë partie politike?								
Po		40%	36%	35%	33.6%	40.6%	35.2%	
<i>PS</i>		15.50%	16.10%	12.3%	11.9%	13.6%	13.4%	
<i>PD</i>		8.50%	9.20%	8.1%	8.4%	9.4%	8.4%	
<i>PL (ish LSI)</i>		3.40%	1.20%	2.1%	2.4%	2%	1.6%	
<i>Tjetër</i>		0.70%	0.40%	0.3%	0.3%	0.2%	0.4%	
Jo		52%	58%	60%	58.8%	54.2%	56.6%	
A jeni anëtar i ndonjë partie politike?								
Po		16%	12%	13%	10.4%	12.5%	12.6%	
<i>PS</i>		6.9%	6.6%	4.6%	4.1%	4.6%	5.8%	
<i>PD</i>		2.6%	3%	2.9%	1.9%	2.6%	2.8%	
<i>PL (ish LSI)</i>		2.2%	0.8%	0.9%	1.1%	0.8%	0.8%	
<i>Tjetër</i>		0.6%	<0.1%	0.2%	<0.1%	0.2%	0.2%	
Jo		75%	81%	82%	81.2%	81.6%	74.8%	



Sondazhi i opinionit publik 2022

Edicioni i 10-të



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

